2023

# HULUMTIMI I MEKANIZMAVE PËR PJESËMARRJEN E QYTETARËVE

FOUNDATION OPEN SOCIETY MACEDONIA
ФОНДАЦИЈА ОТВОРЕНО ОПШТЕСТВО МАКЕДОНИЈА

ФОНДАЦИЈА ЗА РАЗВОЈ НА ЛОКАЛНАТА ЗАЕДНИЦА
LOCAL COMMUNITY DEVELOPMENT FOUNDATION

**Botues:** Fondacioni për Zhvillimin e Komunitetit Lokal Shtip

**Për botuesin:** Nevenka Longurova Girova

**Përgatiti:** Konsalting për zhvillim strategjik

**Autorë:** Kristina Haxhi-Vasileva, Elena Timçeva, Aleksandar Kolekeski, Kristijan Panev

**Lekturë:** Marija Ivanova

**Përkthim:** Dalibor Sandev (mk – shq), Ana Mitva (mk – ang)

**Dizajn:** Andrej Baxhukov

**Shtyp:** Motiv Plus

**Tirazh:** gjithsej 500 (gjuha angleze – 50 kopje; gjuha shqipe – 150 kopje; gjuha maqedonase – 300 kopje)

*Tirazhi pa pagesë / jokomercial

# PËRMBAJTJA


PËRMBAJTJA 03

LISTA E SHKURTESAVE 04

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE 05

HYRJA 07

KONTEKSTI LIGJOR I MAQEDONISË 10

PASQYRJA POLITIKA DHE PJESËMARRJA E QYTETARËVE 15

ORGANIZATAT E QYTETARËVE 19

METODOLOGJIA 22

REZULTATET NGA ANALIZA 24

- PËRFSHIRJA NË PROCESIN E VENDIMMARRJES 24
- TEMAT MBI TË CILAT FOKUSOHEN KONSULTIMET ME QYTETARËT 31
- INTERESIMI I QYTETARËVE PËR PJESËMARRJE 35
- MJETET EKZISTUESE PËR PJESËMARRJE DHE EFIKASITETI I TYRE 39
- EFEKTI NGA PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES 44

MËSIMET E MËSUARA NGA KOVID-19 51

KONSTATIMET KRYESORE 52

MUNDËSITË PËR PËRMIRËSIM 56

BIBLIOGRAFIA 58

# LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| **SB** | EKTORI I BIZNESIT |
| **OQ** | ORGANIZATA E QYTETARËVE |
| **PDU** | PLANI I DETAJUAR URBANISTIK |
| **BE** | BASHKIMI EUROPIAN |
| **GF** | GRUPI I FOKUSIT |
| **FZHKL** | FONDACIONI PËR ZHVILLIMIN E KOMUNITETIT LOKAL |
| **PPU** | PLANI I PËRGJITHSHËM URBANISTIK |
| **ZHLE** | ZHVILLIMI LOKAL EKONOMIK |
| **NJVL** | NJËSIA E VETËQEVERISJES LOKALE |
| **KESL** | KËSHILLI EKONOMIKO-SOCIAL LOKAL |
| **KL** | KOMUNITETI LOKAL |
| **KJ** | ORGANIZATA JOQEVERITARE |
| **KU** | KOMUNITETI URBAN |
| **MB** | MEMORANDIMI I BASHKËPUNIMIT |
| **OBZHE** | ORGANIZATA E BASHKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK |

# PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Konsultimi me qytetarët mbetet gurthemeli i qeverisjes pjesëmarrëse dhe transparente, kyçe për t'u mundësuar qytetarëve që të marrin pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e tyre shoqëror dhe lokal përmes ideve dhe pjesëmarrjes së tyre.Edhe pse bazat e këtij konsultimi janë përcaktuar me kornizat ligjore të vendit, praktika tregon se ekziston hapësirë të konsiderueshme për përmirësim në zbatimin e tyre në nivel lokal.

Kjo analizë, që bazohet një qasje komplekse metodologjike që përfshin anketë të qytetarëve, intervista me pjesëmarrësit lokal dhe grupet e fokusit, synon ofrimin e pasqyrës së plotë të praktikave rrjedhëse dhe perceptimeve të autoriteteve lokale dhe qytetarëve sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve.

Nga kjo analizë mund të konstatohet qastë se autoritetet lokale përpiqen që t'i kyçin qytetarët në proceset e vendimmarrjes. Pavarësisht mekanizmave dhe mjeteve aktuale të prezantuara në kornizat ligjore, ato shpesh perceptohen si të komplikuara dhe detyruese për t'u zbatuar me kritere minimale, që kufizon shfrytëzimin e tyre nga ana e qytetarëve dhe shkakton përdorim selektiv nga ana e autoriteteve lokale.

Qytetarët tregojnë preferencën sa i përket kontaktit të drejtpërdrejtë me vendimmarrësit, që paraqet qasje që edhe autoritetet lokale e konsiderojnë si më efektive. Si rezultat i kësaj, format e konsultimit të drejtpërdrejtë, si mbledhjet e qytetarëve dhe takimet direkte, paraqesin metodat më të shpeshta të përfshirjes.

Interesat e qytetarëve fokusohen mbi temat kyçe siç janë buxheti, planet urbanistike dhe investimet kapitale, por duket se konsultimet shpesherë janë sipërfaqësore dhe shërbejnë më shumë i formalitet. Organizatat e qytetarëve theksojnë se autoritetet kryesisht i përfshijnë qytetarët kur ata përfitojnë drejtpërdrejt nga ajo.

Përveç kësaj, ekziston një nivel i ulët i aktivitetit të qytetarëve në kyçjen e vetëqeverisjes së tyre lokale, që thekson nevojën e përmirësimit të qasjeve dhe mekanizmave për pjesëmarrjen e qytetarëve, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe motivimit të qytetarëve lidhur me pjesëmarrjen.

Edhe pse ekziston bazë ligjore dhe vullnet për pjesëmarrjen e qytetarëve, për realizim efikas dhe përfshirje të vërtetë të qytetarëve në vendimmarrjen lokale nevojiten përpjekje dhe përmirësime shtesë. Kjo analizë ofron një serë rekomandimesh për autoritetet lokale, qytetarët dhe palët e tjera të interesit lidhur me avancimin e proceseve të pjesëmarrjes së qytetarëve në nivel

lokal, me qëllim përfundimtar për arritjen e transparencës më të madhe, llogaridhënies dhe efektivitetit më të mëdha në qeverisjen lokale.

Kjo analizë në vitin 2023 bazohet mbi analizën e mëparshme të vitit 2017[1], që i referohet praktikave ekzistuese të shfrytëzimit të mekanizmave për konsultimin e qytetarëve lidhur me krijimin e politikave lokale dhe efikasitetin e tyre. Në këto dy analiza, tendencat reflektojnë vëzhgime dhe shfida të ngjashme, sa i përket kontekstit të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset lokale të vendimmarrjes, por gjithashtu tregojnë disa prej ndryshimeve evolucionare gjatë kalimit të kohës. Përmbledhja e tendencave kryesore tregojnë pamjen e mëposhtme:

Në të dy analizat theksohet se nevoja e rritjes së ndërgjegjësimit dhe përfshirjes në mënyrë aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Megjithatë, pavarësisht mekanizmave ekzistuese të pjesëmarrjes, problemi me interesin dhe aktivitetin e ulët mbetet i dukshëm.

Të dy analizat theksojnë nevojën e përmirësimit të komunikimit dhe informimit të qytetarëve nga ana e autoriteteve lokale. Komunikimi efektiv konsiderohet si element kyç për përforcimin e pjesëmarrjes dhe transparencës.

Ekziston tendencë për fokusimin e konsultimeve mbi temat specifike, siç janë projektet infrastrukturore dhe planifikimi urbanistik. Gjatë kohës, nevoja për diversifikimit të temave që përfshihen në konsiltimet e këtilla bëhet e dukshme, me qëllim që qytetarëve t'u ofrohen përgjigje sa i përket gamës së gjerë të interesave.

Ekzistojnë mjete të ndryshme për pjesëmarrjen e qytetarëve, por edhe të dy analizat theksojnë problemet lidhur me efektivitetin e tyre dhe pranimin nga qytetarët.

Edhe pse ekziston besim i përgjithshëm se pjesëmarrja e qytetarëve mund të ketë efekt pozitiv, megjithatë ekziston edhe ndjenja e zhgënjimit (frustrimit) kur kjo pjesëmarrje nuk rezulton me ndryshime ose përmirësime të dukshme.

Është evidente edhe pse sfidat dhe tendencat bazë mbeten konzistente midis dy analizave, ekziston proces i pandërprerë lidhur me zhvillimin dhe ndryshimin e praktikave dhe perceptimeve për pjesëmarrjen e qytetarëve, veçanërisht si rezultat i pandemisë Kovid-19. Me këtë, analiza thekson nevojën e përshtatjes dhe inovacionit të vazhdueshëm sa i përket metodave dhe mjeteve për përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal.

[1] Analiza e praktikave ekzistuese të shfrytëzimit të mekanizmave për konsultimin e qytetarëve lidhur me krijimin e politikave lokale dhe efikasitetin e tyre [Burimi elektronik]/[Kristina Haxhi-Vasileva]. – Shtip: Fondacioni për Zhvillimin e Komunitetit Lokal, 2017.

# HYRJA

Qëllimi i kësaj analize, që u realizua në kuadër të projektit "**Mbështetja organizative për përforcimin e demokracisë lokale**" është rishikimi dhe përditësimi i praktikave aktiale të pjesëmarrjes së qytetarëve, përkatësisht efektivitetit të mekanizmave për sigurimin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset e krijimit të politikave publike dhe vendimmarrjen në nivel lokal në disa vitet e fundit, duke përfshirë edhe periudhën e pandemisë Kovid-19. Duke pasur parasysh analizën e mëparshme nga viti 2017 si pikënisje, ky hulumtim tregon përditësimin e sjelljes së palëve të interesit sa i përket temës në fjalë, me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve reciprokisht të pranueshme.

Me të dhënat dhe konkluzionet e marra, ky projekt përpiqet që të krijojë presion më të madh mbi NJVL-të për përdorimin më të shpejtë dhe përforcimin e mekanizmave të demokracisë së drejtpërdrejtë për pjesëmarrjen e qytetarëve, si dhe të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve lidhur me rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në krijimin e politikave lokale.

Ky projekt fokusohet mbi përmbushjen e qëllimeve të mëposhtme specifike:

**përmirësimii i pozitës së shoqerisë civile për përfaqësim në mënyrë efektive të interesave të grupeve të synuara:**

**përforcimi i qëndrueshmërisë institucionale dhe financiare të OQ-ve (grass roots);**

**rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në krijimin e politikave publike.**

Këto synime janë në përputhje edhe me përpjekjet e BE-së dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për mbështetjen dhe promovimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut përmes përforcimit të demokracisë pjesëmarrëse dhe përfaqësuese, përkatësisht përforcimit të ciklit të përgjithshëm demokratik duke përforcuar rolin aktiv të shoqërisë së qytetarëve, sundimin e ligjit dhe vendosjen e dialogut strukturor me shoqërinë e qytetarëve, që do të kontribuojë dhe do t'u ofrojë përkrahje reformave për integrimin e vendit në Bashkimin Europian.

Përfshirja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes po intensifikohet gjithnjë e më shumë dhe bëhet sinonim i decentralizimit të sukseshëm dhe demokracisë në veprim. Si bazë e këtij procesi është ideja për pjesëmarrje aktive të qytetarëve, ku qytetarët jo vetëm që konsultohen, por kontribuojnë në mënyrë aktive në politikat që u referohen komuniteteve të tyre. Në këtë kuptim, komunikimi efektiv ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve lokale është kyç në identifikimin e prioriteteve dhe përdorimin e resurseve komunale në mënyrë më të mirë të mundshme.

Megjithatë, me qëllim që të arrihet efektiviteti maksimal i këtij procesi, nevojitet që të përsoset komunikimi dhe të krijohen dhe përmirësohen mekanizmat institucionale që do të mundësojnë pjesëmarrjen më të gjerë dhe më thelbësore të qytetarëve. Kjo përfshihet mundësinë qytetarët të vendosen në gjendje ku do të shprehen dhe do të ndikojnë mbi vendimet që prekin drejtpërdrejtë ata, por edhe autoritetet lokale do të jenë në gjendje ku do të marrin përkrahje të plotë dhe legjitimitet lidhur me politikat e tyre.

Me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të gjendjes aktuale të mekanizimave për pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal, kjo analizë merr parasysh përvojat dhe praktikat e autoriteteve lokale dhe qytetarëve. Qëllimi është që të identifikohen fushat ku ka nevojë për përmirësime, si dhe të propozohen hapa konkrete për realizimin e tyre, me ç'rast do të rritet pjesëmarrja dhe demokracia në Maqedoni.

Në bazë të asaj që është cekur më lart, qëllimet konkrete të kësaj analize janë:

- **Analizimi i gjendjes aktuale lidhur me mekanizmat e konsultimit të qytetarëve në procesin e krijimit të politikave publike në nivel lokal**
- **Mundësimi i diskutimit ndërmjet pjesëmarrësve lokal (NJVL, OQ dhe SB)**
- **Stimulimi i ndarjes dhe përsëritjes së praktikave të mira të mekanizmave të konsultimit ndërmjet njësive të VL-ve**
- **Lobimi në njësitë e VL-së për institucionalizimin e mekanizimave të propozuar**

Duke pasur parasysh sfidat dhe potencialet aktuale, kjo analizë synon që të shërbejë si bazë për krijimin e vetëqeverisjes lokale më të hapur dhe inklusive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që në mënyrë aktive përfsjin qytetarët e vetë në proceset e vendimmarrjes dhe në atë mënyrë kontribuon në krijimin e vetëqeverisjeleve lokale më të qëndrueshme dhe efektive.

# KONTEKSTI LIGJOR I MAQEDONISË

Përfshirja aktive dhe transparente e qytetarëve në krijimin e rregullativës paraqet parakusht për zhvillimin e një shoqërive demokratike, postulatetet e së cilës janë vlerat demokratike, transparenca dhe llogaridhënia. Koncepti bashkëkohor demokratik i pjesëmarrjes aktive të qytetarëve pret që qytetarët me vigjilencë ta monitorojnë punën e përfaqësuesve të tyre të zgjedhur dhe në mënyrë të vazdhueshme të përfshihen në zhvillimin e politikave lokale dhe jo vetëm të reagojnë ndaj tyre pasi ato do të miratohen. Sipas kësaj, me pjesëmarrjen e qytetarëve nënkuptohet çdo aktivitet me të cilin qytetarët bashkohen për t'u informuar, diskutuar lidhur me problemet në komunitetin e tyre, për të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e vendimmarrjeve publike dhe për të ofrtuar zgjidhje të mundshme për krijimin e politikave, me ç'rast do të ndikojnë mbi cilësinë e jetesës së tyre dhe bashkëqytetarëve të tyre. Përmes pjesëmarrjes së tillë të palëve të interesit, pushteti ka qasje në ide të reja, informacione dhe resurse të rëndësishme në procesin e krijimit të politikave, ndërsa konsultimet e tilla kontribuojnë në krijimin e besimit të ndërsjellë dhe zhvillimin e parimeve demokratike.

Kjo formë e angazhimit të qytetarëve, d.m.th., qytetarë që janë përfshirë në mënyrë aktive në përmirësimin e komuniteteve dhe vendit të tyre, ka dobi të jashtëzakonshme për shoqërinë e qytetarëve dhe paraqet treguesi kryesor i "shëndetit" të komuniteteve, shtetit demokratik dhe shkallës së kënaqësisë së qytetarëve.

Në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga viti 2002 përfshihen disa mundësi për pjesëmarrje të qytetarëve, por u lihet hapësirë komunave për mundësi të reja dhe mundësi shtesë për përfshirjen e qytetarëve. Megjithatë, hulumtimi i Fondacionit për Zhvillimin e Komunitetit Lokal Shtip për pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë periudhës para pandemisë tregoi një situatë sfiduese kur bëhet fjalë për përfshirjen e qytetarëve si partnerë të barabartë në procesin e vendimmarrjes. Domethënë, edhe pse qytetarët dhe autoritetet lokale në dispozicion kanë mjete dhe mekanizima në formë dokumentesh

ligjore, ato janë të komplikuara, qytetarët rrallë iniciojnë ato dhe mirëmbahen nga përdorimi i tyre, ndërsa autoritetet lokale në mënyrë selektive i përdorin ato dhe i privojnë nga karakteristikat ligjore, që do të thotë se i përdorin në formë të thjeshtësuar dhe të përshtatur[2].

Qëllimi i kësaj analize, që u realizua në kuadër të projektit "**Mbështetja organizative për përforcimin e demokracisë lokale**" është rishikimi dhe përditësimi i praktikave aktiale të pjesëmarrjes së qytetarëve, përkatësisht efektivitetit të mekanizmave për sigurimin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset e krijimit të politikave publike dhe vendimmarrjen në nivel lokal në disa vitet e fundit, duke përfshirë edhe periudhën e pandemisë Kovid-19. Duke pasur parasysh analizën e mëparshme nga viti 2017 si pikënisje, ky hulumtim tregon përditësimin e sjelljes së palëve të interesit sa i përket temës në fjalë, me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve reciprokisht të pranueshme.

Me të dhënat dhe konkluzionet e marra, ky projekt përpiqet që të krijojë presion më të madh mbi NJVL-të për përdorimin më të shpejtë dhe përforcimin e mekanizmave të demokracisë së drejtpërdrejtë për pjesëmarrjen e qytetarëve, si dhe të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve lidhur me rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në krijimin e politikave lokale.

Ky projekt fokusohet mbi përmbushjen e qëllimeve të mëposhtme specifike:

| | | |
|---|---|---|
| **përmirësimii i pozitës së shoqerisë civile për përfaqësim në mënyrë efektive të interesave të grupeve të synuara:** | **përforcimi i qëndrueshmërisë institucionale dhe financiare të OQ-ve (grass roots);** | **rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në krijimin e politikave publike.** |

Këto synime janë në përputhje edhe me përpjekjet e BE-së dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për mbështetjen dhe promovimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut përmes përforcimit të demokracisë pjesëmarrëse dhe përfaqësuese, përkatësisht përforcimit të ciklit të përgjithshëm demokratik duke përforcuar rolin aktiv të shoqërisë së qytetarëve, sundimin e ligjit dhe vendosjen e dialogut strukturor me shoqërinë e qytetarëve, që do të kontribuojë dhe do t'u ofrojë përkrahje reformave për integrimin e vendit në Bashkimin Europian.

# KONTEKSTI LIGJOR I MAQEDONISË

Pjesëmarrja e qytetarëve lidhur ngusht me procesin e decentralizimit, përkatësisht organizimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale në vend dhe bartja e numrit të madh të kompetencave nga niveli qendro në nivelin lokal të qeverisjes. Procesi i sukseshëm i decentralizimit nënkupton edhe

[2] Analiza e praktikave ekzistuese të shfrytëzimit të mekanizmave për konsultimin e qytetarëve lidhur me krijimin e politikave lokale dhe efikasitetin e tyre [Burimi elektronik]/[Kristina Haxhi-Vasileva].

inkluzionin e qytetarëve, përkatësisht përfshirja dhe komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet vetëqeverisjes lokale dhe pushtetit në procesin e vendimmarrjes dhe krijimit të politikave, me ç'rast autoritetet lokale janë në gjendje që më mirë t'i identifikojnë nevojat lokale dhe në mënyrë më efikase t'i menaxhojnë shpenzimet publike.

Korniza ligjore për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrjen në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullohet me **Ligjin e Vetëqeverisjes Llokale**[3] si "përfshirja individuale ose kolektive e banorëve të komunës në procesin e vendimmarrjes lidhur me çështje ne rëndësi lokale në nivele të ndryshme të vendimmarrjes". Ligji parasheh mundësinë e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes për çështje ne rëndësi lokale përmes nismës së qytetarëve, mbledhjeve të qytetarëve dhe rederendumit (neni 25), si dhe përmes dorëzimit të peticioneve dhe propozimeve (neni 29) dhe tribunave publike, anketave dhe propozimeve (neni 30). Gjithashtu, në komunat ku më së paku 20% e numrit të përgjithshëm të banorëve të përcaktuar në regjistrimin e fundit të popullsisë janë anëtar të një komuniteti të caktuar, krijohet Komision për marrëdhënie ndërmjet komuniteteve, detyra e të cilit është shqyrtimi i çështjeve që u referohen marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve të përfaqësara në komunën e caktuar dhe ofron mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre (neni 55).

Shpenzimet për zbatimin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, sipas ligjit në fjalë, i mbulon buxheti komunal (neni 25).

Sipas këtij ligji, si dokument me fuqi më të madhe ligjore në komunat është definuar Statuti. Me statutin, rregullohen organizimi dhe veprimet e organeve komnale, si dhe aspektet e tjera të rëndësishme, që u referohen përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, mënyrës së informimit të qytetarëve, rasteve me përjashtim të publikut nga mbledhjet e këshillit, peticioneve dhe propozimeve të qytetarëve, si dhe veprimit lidhur me to, mënyrës së organizimit të tribinave publike, realizimit të anketave dhe mbledhjes së propozimeve të qytetarëve. Çdo komunë mund, në Statutin e vetë, të propozojë mënyra të tjera të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve, sipas Kushtetutës dhe ligjit në fjalë.

Për shqyrtimin e çështjeve dhe përcaktimin e propozimeve, që i referohet cilësisë së shërbimeve të organeve publike të komunës, këshilli mund të krijojë Komision për mbrojtjen e konsumatorëve, i përbërë nga përfaqësuesit e grupeve më të mëdha të përdoruesve të shërbimeve publike.

Ligji i Vetëqeverisjes Lokale, gjithashtu, imponon nevojën që mbledhjet e këshillit të bëhen publike dhe të mos përjashtohet prania e publikut në debatet për buxhetin komunal, llogaritë dhe raportet vjetore financiare të komunës, si dhe për planet urbanistike.

Mënyra dhe procedura për sigurimin e pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të qytetarëve, përkatësisht shpallja dhe zbatimi i referendumit, konvokimi dhe mbajtja e tubimit të qytetarëve dhe inicimi i nismës së qytetarëve për çështje me rëndësi nacionale ose lokale, gjithahstu rregullohen edhe me **Ligjin e Referendumit dhe Formave të Tjera të Deklarimit të Drejtpërdrejtë të Qytetarëve**[4].

[3] Ligji I Vetëqeverisjes Lokale 2002 – "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.5/2022, më date 29 janar 2022.

[4] Ligji I Referendumit - (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.81/2005); Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë Nr.K.195/2005, më datë 21 dhe 22 dhjetor 2005 (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.81/2005 nr.3.2006)

Me këtë ligj, definohen kushtet dhe mënyrat sipas të cilave zbatohet referendumi, nisma e qytetarëve dhe tubimi i qytetarëve.

Referendumi në nivelin lokal ngrihet nga këshilli për çështje në ingerencat e tij, me iniciativë të tij ose me kërkesë të më së paku 20% të qytetarëve të komunës, ndërsa nuk është lejuar që të ngrihet për çështje që u referohen buxhetit dhe llogarisë përfundimtare të buxhetit të komunës. Vendimet konsiderohen si të miratuara nëse janë votuar nga shumica e numrit të përgjithshëm të qytetarëve që kanë votuar ose nëse kanë votuar më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për komunën përkatëse. Vendimi i miratuar në referendum është i detyrueshëm për këshillin, që në afat prej 60 ditëve pas shpalljes së rezultateve të referendumit, obligohet ta rregullojë këtë çështje për të cilën është vendosur në referendum, në përputhje me rezultatet e referendumit.

Nisma e qytetarëve në nivel lokal mund të ngrihet për miratimin e akteve të caktuara të komunave dhe shpalljen e referendumit në nivel lokal.

Nisma e qytetarëve në nivel lokal konsiderohet si e ngritur nëse së paku 10% e qytetarëve të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore të komunës me nënshkrime të tyre kanë mbështetur nismën. Këshilli i komunës, obligohet ta shqyrtojë propozimin në afat prej 30 ditëve pas ngritjes së nismës dhe t'i informojë qytetarët. Nisma e qytetarëve në nivel lokal, për të cilën është ngritur propozimi, propozuesi obligohet që ta zbatojë atë në afat prej një muaji nga dita e pranimit të njoftimit për rregullsinë e saj.

Tubimi i qytetarëve thirret për shkak të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve për çështje të caktuara me rëndësi lokale dhe çështje me rëndësi për KL ose KU dhe për shkak të ngritjes së nismave për zgjidhjen e çështjeve me rëndësi lokale. Në këto tubime, qytetarët me vendbanim në atë zonë, shqyrtojnë problemet, marrin qendrime dhe përgatisin propozime sa i përket temave me rëndësi të drejtpërdrejtë dhe të përditshme për jetën dhe punën e komunës ose komunitetit lokal.

Kryetari i komunës thirr tubimin e qytetarëve, me nismë të tij, me kërkesë të këshillit ose me kërkesë të së paku 10% të qytetarëve, të regjistruar në listën zgjedhore të komunës, përkatësisht komunitetit lokal ose urban për të cilin është thirrur tubimi. Organet e komunës, në afat prej 90 ditëve nga dita e mbajtjes së tubimit, obligohen që t'i shqyrtojnë konkluzionet dhe t'i informojnë qytetarët për vendimet e tyre.

Secili qytetar ka të drejtë, individualisht ose së bashku me të tjerët, të dorëzojë peticione dhe propozime për punën e organeve të komunës dhe administratës së komunës. Në çdo rast, kryetari obligohet të krijojë kushte për dorëzimin e peticioneve dhe propozimeve, të dorëzojë përgjigje të arsyetuar te parashtruesi jo më vonë se në afat prej 60 ditëve nga dita e pranimit të peticionit, ndërsa peticionet dhe propozimet që nuk u referohen çështjeve në kompetencë të organeve të komunës, duhet t'i dorëzojë te organi përkatës kompetent dhe për atë ta informojë parashtruesin.

Gjatë hartimit të rregulloreve të komunës, këshilli, përkatësisht kryetari, mund të organizojë paraprakisht tubime publike, të zbatojë anketa ose të kërkojë propozime nga qytetarët.

Këtyre formave të konsultimit të qytetarët nëpër komunat, në dhjetë vitet e fundit e është shtuar edhe procesi i quajtur forumet e komunitetit. Shumica e komunave në Maqedoninë e Veriut

parashikojnë formuat në statutet e tyre, para se të gjithash si rezultat i programit për zhvillim të Ambasadës së Zvicrës, që promovon atë si një prej formave të përfshirjes së qytetarëve në krijimin dhe miratimin e vendimeve në vetëqeverisjes lokale.

Analizat dhe vlerësimet aktuale konfirmojnë se shumica e dispozitave, që u referohen transparencës, pjesëmarrjes dhe llogaridhënies, nuk zbatohet plotësoshet dhe si rezultat i kësaj është edhe mungesa e kapaciteteve të NJVL-ve. Ndër të tjera, theksohet se për realizimin e mjeteve të caktuara për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, nivelin, përkatësisht cenzusin është jashtëzakonisht i lartë dhe paraqet pengesë për zbatimin e këtyre mjeteve. Mungesa e kapaciteteve nëpër komunat, mungesa e buxhetit individual për zbatimin e dispozitave të ligjit në fjalë dhe mungesa e rregullave të qarta mbi zbatimin e tyre përforcon përshtypjen se zbatimi i dispozitave është i lënë vullnetit të komunitetit të donatorëve dhe se mungon vullneti i pjesëmarrësve lokal për kontroll më të madh mbi këto procese në nivel lokal[5].

Me ndryshimet e fundit të **Ligjit të Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale**[6], theksohet rëndësia e transparencës në punën e komunës. **Ligji i Buxheteve**[7] dhe **Ligji i Realizimit të Buxheteve**[8] theksojnë transparencën në proceset e buxhetimit në nivelin lokal. Gjithashtu, me Ligjin e Buxheteve parashihet se "komunat në nivelin lokal duhet të vendosin mekanizëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e propozimit të nismave të reja në përgatitjen e planeve strategjike dhe strategjisë fiskale të komunës".

Një legjislacion tjetër dhe mjet i fuqishëm për realizimin e së drejtës së informimit dhe garancisë e sigurimit të transparencës dhe hapjes së komunave dhe institucioneve, përkatësisht poseduesve të informacioneve paraqet **Ligji i Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik**[9]. Me këtë ligj, mundësohet personave fizikë dhe juridikë që ta realizojnë të drejtën e qasjes së lirë në informacione me karakter publik, ndërsa poseduesit e informacioneve për punën e tyre kanë obligim ta mundësojnë informimin e publikut. Në vitin 2018, OSCE publikoi Analizën ligjore të ndryshimeve të propozuara të Ligjit të Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik, ku mes thjerash, u theksua edhe nevoja e harmonizimit me standardet ndërkombëtare, përkatësisht organeve publike t'u detyrohet publikimi proaktiv i një serë informacionesh me interes publik edhe kur për atë nuk ekziston kërkesë konkrete. Analiza në fjalë imponon procedurat për qasjen në informacionet të bëhen të thjeshta, të shpejta dhe të lira, ndërsa mbrojtja e privatësisë duhet të jetë një prej prioriteteve[10].

[5] Raport për vlerësimin e zbatimit të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale – Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, prill 2020/Analiza e praktikave ekzistuese të shfrytëzimit të mekanizimave për konsultim me qytetarët në krijimin e politikave locale dhe efikasitetit të tyre – Fondacioni për Zhvillimin e Komunitetit Lokal, Shtip, 2017

[6] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.172/22)

[7] Ligji i Buxheteve (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr.203, më datë 19.09.2022)

[8] Ligji i Realizimit të Buxheteve (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr.282, më datë 27.12.2022)

[9] Ligji i Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr.101, më datë XXXXXXXX

[10] Analiza ligjore e ndryshimeve të propozuara të Ligjit të Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik – OSCE, 2018

Në këtë drejtim, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale në vitin 2023 hartoi **Kodin e transparencës në nivel lokal**[11], me të cilin rregullohen standardet e sigurimit të transparencës minimale të pushtetit lokal.

Në këtë drejtim, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale në vitin 2023 ka përgatitur Kodin e Transparencës në nivel lokal, i cili rregullon standardet për sigurimin e transparencës minimale të pushtetit lokal, me rastin e krijimit të këtyre standardeve, interesi i qytetarëve/organizatave qytetare për të marrë të caktuara informacione dhe të dhëna që janë të rëndësishme për ta për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies, përfshirjen e tyre në proceset e politikëbërjes në nivel vendor, si dhe informacionin që qytetarët besojnë se do të lehtësojë qasjen e tyre në shërbimet publike. Sipas hulumtimit të fundit, pra Indeksit të Transparencës Aktive, transparenca aktive e komunave në vitin 2023 ishte 74%, dhe rajoni më transparent në vend është rajoni lindor, pas të cilit janë rajonet juglindore dhe jugperëndimore. Për vite me radhë, Shkupi ka qenë rajoni më pak transparent në vend. Gjatë krijimit të këtyre standardeve, interesi i qytetarëve/organizatave të qytetarëve për marrjen e informacioneve dhe të dhënave të caktuara të cilat janë të rëndësishme për ata për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies, përfshirja e tyre në proceset e politikëbërjes në nivelin lokal, si dhe informacionet që qytetarët i konsiderojnë se ato do të lehtësojnë qasjen e tyre në shërbimet publike se janë marrë parasysh. Sipas hulumtimeve të fundit, përkatësisht Indeksit të Transparencës Aktive, transparenca aktive e komunave në vitin 2023 ka qenë 74%, ndërsa rajoni më transparent në vend ka qenë rajoni lindor dhe pastaj vijojnë rajoni juglindor dhe rajoni jugperëndimor. Për vite me radhë, Rajoni i Shkupit ka qenë rajoni më pak transparent në vend[12].

Sa i përket hapjes së komunave, përkatësisht Indeksit të hapjes, që ka qenë aktive për herë të fundit në vitin 2022 është 27%, që paraqet tregues i nivelit të ulët të hapjes lidhur me punën e pushtetit lokal në RMV-në. Ndër komunat me "hapje" më të madhe janë Vallandova (62%), Prilepi (59%), Manastiri (57%), Ohri (54%) dhe të tjera, ndërsa me hapje më të ulët janë Buteli (6%), Sopishtja (5%), Haraçinova dhe Zelenikova (3%) dhe komuna e Krivogashtanit me 0%[13].

Me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm të vetëqeverisjes lokale si niveli më i afërt i qeverisjes me qytetarët dhe njëkohësisht harmonizimit të sistemit me kriteret dhe standardet normative, institucionale, politike dhe administrative të BE-së, në kuadër të Vendimit për fillimin e negociatave të RMV-së për anëtarësim në BE, u hartua edhe **Programi i ri për Zhvillim të Qëndrueshëm Lokal dhe Decentralizim 2021-2026**[14]. Rezultatet e pritura të programit në fund të periudhës së planifikuar programore parashikojnë ndryshime thelbësore pozitive në funksionimin e vetëqeverisjeve lokale, ndër të tjera, zbatimi transparent dhe i përgjegjshëm të kompetencave dhe përfshirja konsekuente të qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në proceset e hartimit, miratimit dhe zbatimit të vendimeve, politikave dhe masave të rëndësishme lidhur me zhvillimin ekonomik lokal.

Parimet e transparencës dhe pjesëmarrjes, d.m.th. nevoja për informim të rregullt, në kohë dhe në mënyrë objektive të publikut lidhur me masat e politikës për të nxitur zhvillimin e barabartë rajonal, për të mundësuar hyrje të lirë në informacionet për palët e interesit (transparencë) dhe për të përfshirë në mënyrë aktive qytetarët në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikës rajonale (pjesëmarrje) janë përfshirë edhe me **Ligjin e Zhvillimit të Barabartë Rajonal**[15] dhe **Strategjinë e re dhjetëvjeçare të Zhvillimit Rajonal të RMV-së - 2021-2031**[16].

[11] Kodi i transparencës në nivel local, USAID, shtator, viti 2022

[12] Indeksi I transparencës aktive 2023 – Fondacioni Shoqëria e Hapur dhe Qendra e Komunikimeve të Qytetarëve, korrik 2023

[13] Vlerësimi i qeverisjes së mire të njësive të vetëqeverisjes lokale nëRepublikën e Maqedonisë së Veriut përmes indeksit të hapjes – Fondacioni Metamorfozis, gusht 2022

[14] Programi i zhvillimit të qëndrueshëm local dhe decentralizimit 2021-2026, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale

[15] Ligji i Zhvillimit të Barabartë Rajonal (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr.24, më datë 29.01.2021)

[16] Strategjia për zhvillim rajonal të RMV-së – 2021-2031

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Byroja e Zhvillimit të Barabartë Rajonal dhe 8 Qendra të veçanta për Zhvillimin e Rajoneve të Planifikimit janë përgjegjëse për zbatimin e Ligjit të Zhvillimit të Barabartë Rajonal dhe Strategjinë e zhvillimit Rajoinal të RMV-së.
Sa i përket rritjes së pjesëmarrjes në miratimin e programeve për zhvillim të rajoneve të planifikimit, si dhe për sigurimin e zgjidhjeve që do t'i adresojnë nevojat reale të qytetarëve të karakterit rajonal, byroja e lartpërmendur ka hartuar koncept për forumet rajoanle të komunitetit si mjet për identifikimin, prioritizimin dhe përgatitjen e projekteve që financohen nga MVL-ja dhe BZHR-ja[17].

# PASQYRA POLITIKE DHE PJESËMARRJA E QYTETARËVE

Gjatë viteve të fundit, ndryshimet politike dhe ekonomike të shkaktuara nga pandemia Kovid-19, kriza ekonomike dhe energjetike vazhduan ta formësojnë në shkallë të madhe jetën sociale, ekonomike dhe politike në Maqedoninë e Veriut. Pas zgjedhjeve lokale në muajin tetor të vitit 2021, reliefi politik në vend ka pësuar ndryshime serioze pasi koalicioni ndërmjet Lidhjes Socialdemokratike të Maqedonisë (LSDM) dhe Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), që udhëhoqi vendin në zgjedhjet e fundit parlamentare në muajin të vitit 2020, ka humbur shumicën politike dhe udhëheqjen në qytetet më të mëdha, duke përfshirë edhe qytetin e Shkupit. Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas (OBRM-PDBKM) arriti të fitojë shumicën e voave në 42 komuna dhe shkaktoi dorëheqjen e kryeministrit të atëhershëm Zoran Zaev nga të gjitha funksionet poltike[18]. Fushatat zgjedhore dhe premtimet e dy partive udhëheqëse politike në vend ishin kryesisht të orientuara drejt angazhimeve të kahershme të vendit për anëtarësim në BE dhe vonesave të shumta për fillimin e negociatave për shkak të konfliktit të pazgjidhur me Bullgarinë, mosmarrëveshjeve të Qeverisë në lidhje me trajtimin e efekteve të pandemisë Kovid-19, si dhe situatës ekonomike të ndjekur me rritjen e përqindjes së papunësisë dhe emigracionit[19]. Zgjedhjet lokale në vitin 2021 ofruan gjithashtu një gamë "të shumëngjyrëshe" të listave të këshilltarëve dhe përbërjeve të këshillave komunale, d.m.th., përveç partive të mëdha, vota kanë përfituar edhe kandidatët/këshilltarët nga partitë më të vogla, si dhe listat e pavarura. Nga gjithsej 67 lista të pavarura të këshillave, kandidatët nga 44 lista të pavarura me pothuajse 55.000 vota kanë arritur të hyjnë në këshillat komunale, nga të cilët 3 kandidatë janë zgjedhur edhe kryetarë të komunave. Kjo tregon se pakënaqësia në rritje në zgjidhjen e problemeve lokale dhe mosbesimi tek partitë e mëdha qytetarët e kanalizojnë duke ndërmarrë hapa konkretë për pjesëmarrje dhe kontroll në proceset e vendimmarrjes nëpër komunat e tyre[20].
Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor[21] në muajin mars të vitit 2024, pragu për mbledhjen e nënshkrimeve për kandidimin e deputetëve të pavarur rritet dhe është 1% e zgjedhësve të

[17] Forume rajonale për mjetin e përvashkët të identifikimit, prioritizimit dhe hartimit të projekteve për financim nga MVL-ja dhe BZHR-BZHR-ja, 2020
[18] Indeksi i qëndrueshmërisë së shoqërisë së qytetarëve për Maqedoninë e Veriut në vitin 2021, USAID, FHI 360
[19] Misioni i ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve, Raporti përfundimtar për Zgjedhjet lokale, më datë 17 dhe 31 tetor, viti 2021
[20] Raporti i rishikuar për zbatimin e zgjedhjes së anëtarëve të këshillave të komunave dhe këshillit të Qytetit të Shkupit dhe kryetarëve të komunave dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit – Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve / https://rb.gy/pkjuo
[21] Kodi Zgjedhor, mars 2024, https://drive.google.com/file/d/1ZJMruqcNl-yC5VuWSzpfT9BFeKphm5An/view (duke kyçur më datë 5 prill 2024).

regjistruar në njësinë zgjedhore, me ç'rast vështirësohet mundësia qytetarët, shoqatat e qytetarëve dhe listat e pavarura që të kandidohen. Ligji në fjalë u votua pa debat dhe diskutim paraprak publik.

Gjithashtu, sipas analizës së përgjithshme të përfaqësimit gjinor, nga gjithsej 1347 këshilltarë të zgjedhur, 491 ose 36.45% janë gra. Nga gjithsej 80 këshilla komunalë dhe 1 këshill i qytetit, vetëm në një komunë (komuna e Konçes) këshilltaret gra janë të përfaqësuara në përqindje më shumë se këshilltarët meshkuj, ndërsa në dy këshilla komunale (komuna e Qendër Zhupës dhe Plasnicës) është zgjedhur vetëm nga një grua. Edhe pse nuk është përmbushur kuota gjinore se të paktën 40% e kandidatëve/kandidateve në listat zgjedhore për këshillat komunale duhet të jenë persona të gjinisë së nënpërfaqësuar, vërehet pak progres në balancën gjinore në pjesëmarrjen politike, në krahasim me kuotën prej 30%, që legjislacioni e kishte parashikuar më parë.

Duke iu referuar pjesëmarrjes së qytetarëve si tregues i "shëndetit" të komunitetit dhe zhvillimit demokratik të një vendi, kërkimet në vitet e fundit tregojnë se kriza shëndetësore dhe gjendja epidemiologjike në vend e shkaktuar nga Kovid-19, pasojat prej tyre në jetën e qytetarëve, institucionet dhe ekonomia, megjithatë kanë ndikuar mbi shkallën e kënaqësisë së qytetarëve lidhur me funksionimin e pushtetit lokal dhe angazhimin e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes[22].

Kështu, në krahasim me periudhën para pandemisë dhe hulumtimin e kryer në periudhën 2012-2016[23], gjatë dhe pas periudhës së Kovid-it nuk vërehen ndryshime të mëdha sa i përket shkallës së kënaqësisë dhe ndjenjës së përkatësisë së qytetarëve në vendbanimin e tyre (qytet apo fshat), por vërehet rënie e kënaqësisë së përgjithshme për vendin - Republikën e Maqedonisë së Veriut si vendbanim[24].

Qytetarët e kënaqur me funksionimin e përgjithshëm të pushtetit lokal (41%) konsiderojnë se komunat punojnë mirë dhe shumë mirë dhe janë përgjithësisht të kënaqur me shërbimet që i ofrojnë ato (44%), duke përfshirë disponueshmërinë e informacioneve nga komuna (gazeta komunale, faqja e internetit, televizionin lokal / radion lokale...) dhe informacionet për shërbimet dhe aktivitetet komunale.

Nga ana tjetër, si aspekte kryesore të pakënaqësisë së qytetarëve në lidhje me punën e autoriteteve lokale veçohen: disponueshmëria e informacioneve për punën e këshillit komunal, informacionet për shërbimet dhe aktivitetet shtetërore, mundësia për pjesëmarrje në vendimmarrjen strategjike me rëndësi lokale (42%), njohja me shpenzimet e buxhetit komunal (më të larta 48%), promovimi i bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike dhe lufta kundër korrupsionit[25].

Nota mesatare për opinionin e qytetarëve lidhur me funksionimin e përgjithshëm të pushtetit lokal është vlerësuar me 3.2 nga 5, ndërsa kënaqshmëria prej demokracisë lokale, transparencës dhe llogaridhënies ishte vlerësuar me 2.81.

[22] Pjesëmarrja e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020-2022 – Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia

[23] Qytetarët dhe komunitetet e tyre: Pjesëmarrja e qytetarëve, aktivizmi dhe vullnetarizmi në Republikën e Maqedonisë – FOOM, Reaktor – Shkup, 2016

[24] Pjesëmarrja e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me pasqyrë shtesë mbi pandeminë Kovid-19 – Fondacioni Shoqëria e Hapur, Reaktor, Qendra e Komunikimeve të Qytetarëve, Evrotink, 2021

[25] Raport nga hulumtimi i mendimit publik për kënaqësinë e qytetarëve nga shërbimet në nivel lokal – UNDP, Indago, shtator 2022

Këto të dhëna për periudhën 2019-2022 konfirmojnë fluksin e pandryshuar të opinionit të qytetarëve me periudhën para pandemisë (2016-2017), ku analizat[26] tregojnë se autoritetet lokale më shumë fokusohen në ndërmarrjen e aktiviteteve për informimin e qytetarëve dhe jo në përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes.

Kënaqësia e përgjithshme e qytetarëve nga autoritetet lokale tregohet se lidhet drejtpërdrejt edhe me perceptimin e qytetarëve për mundësinë e ndikimit mbi vendimet që miratohen në institucionet lokale. Domethënë, mbi 80% e popullsisë që janë deklaruar të pakënaqur me pushtetin lokal, konsiderojnë se nuk mund të ndikojnë mbi vendimet e miratuara në nivel lokal, edhe pse me rëndësi për ata është që të jenë pjesë e procesit (65%). Pakënaqësia e tillë dhe perceptimi negativ për ndikimin e vogël mbi institucionet lokale në proceset e vendimmarrjes reflektohet edhe në "trendin" negativ të pjesëmarrjes së qytetarëve të realizuar, d.m.th në numrin e qytetarëve që ishin përfshirë në ndonjë nismë të organizuar të qytetarëve për përmirësimin e vendbanimit të tyre. ku vërehet rënie nga 20% në periudhën 2019-2020, në 15% në vitin 2021 dhe vazhdon me tendencë negative edhe në vitin 2022[27].

Qytetarët aktivë, të cilët megjithatë kanë marrë pjesë në ndonjë aktivitet të organizuar të qytetarëve ose në procesin e miratimit të politikave apo vendimeve në nivel lokal, më së shpeshti kanë qenë pjesë e tubimit të qytetarëve (60%), iniciativës së qytetarëve (35%), debatit publik (32). %), ditës së hapur të kryetarit të komunës (27%), sondazheve të opinionit publik (26%), forumeve në komunitetet (18%), mbledhjeve të këshillit (13%), ose referendumit (10%). Në krahasim me vitin 2021, në vitin 2022 është matur pjesëmarrje më e madhe në tubimet e qytetarëve dhe forumet në komunitetet, por edhe përqindje më e ulët për pjesëmarrje në nismat e qytetarëve, sondazhet e opinionit publik, mbledhjet e këshillit dhe referendumet. Për dallim nga viti 2021, kur u pranuan rreth 22% të propozimeve/nismave të propozuara, në vitin 2022 kjo përqindje është më e lartë dhe ka arritur në 34%. Përqindja është më e lartë (rritje nga 19% në vitin 2021 në 33% në vitin 2022) e atyre propozimeve/nismave që ishin në procedurë ose në pritje të vendimit, ndërsa numri i propozimeve/nismave të refuzuara është ulur (nga 49% në 30%). Numri më i madh i këtyre nismave ka qenë lidhur me zgjidhjen e problemeve komunale (36%), aksionet për ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor (25%), nismat për urbanizëm dhe riparimet e infrastrukturës (20%), arsimin (12%), politikat sociale dhe punësimin (3.3%), kulturën, rendin dhe qetësinë publike[28] etj..

Situata me format e tjera të aktivizmit të qytetarëve ndër vite vazhdon ta ndjekë nivelin e palakmueshëm. “Kontakt aktivizmi”, përkatësisht kontakti i drejtpërdrejtë me institucionet përkatëse për zgjidhjen e çështjeve të caktuara në krahasim me vitet e kaluara, tregon rritje të vogël prej 10% (viti 2020 -18%, viti 2021 - 28%), përkatësisht rritje të vogël të numrit të qytetarëve që kanë kontaktuar drejtpërdrejt me përfaqësuesit e institucioneve lokale (kryetarët e komunave, këshilltarët) dhe partitë politike, si dhe përqindjes së qytetarëve që kanë marrë pjesë në debatet publike, tubimet publike, grupet e punës, kanë nënshkruar peticione, kanë shfrytëzuar mundësinë e tyre për peticion ose kanë dorëzuar propozim nëpër institucionet. Megjithatë, tendencat e tilla vihen re më shumë në periudhën e mbajtjes së disa ngjarjeve politike apo

[26] Analiza e praktikave ekzistuese të shfrytëzimit të mekanizmave për konsultim me qytetarët për krijimin e politikave lokale dhe efikasitetin e tyre – Kristina Haxhi-Vasileva, Fondacioni për zhvillimin e komunitetit lokal, Shtip, 2017

[27] Pjesëmarrja e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020-2022 – Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedonia

[28] Raport nga hulumtimi i mendimit publik për kënaqësinë e qytetarëve nga shërbimet lokale – UNDP, Indago, shtator 2022 / Pjesëmarrja e qytetarëve dhe perspektivat e BE-së: Analiza e mendimit publik – Reaktor – Hulumtim në veprim, 2021

sociale, siç janë zgjedhjet lokale në vitin 2021, të cilat në periudha të caktuara shkaktojnë rritje apo ulje të intensitetit të përdorimit të mjetit.

Pavarësisht rritjeve minimale të përdorimit të disa prej mjeteve për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve, si dhe kontaktit të drejtpërdrejtë, ende mbizotëron konkluzioni i përgjithshëm se ende ekziston përdorimi relativisht i ulët i mekanizmave ekzistuese për pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes apo vendimeve të rëndësi lokale, ndërsa ekziston edhe nevoja reale për përfshirje më të madhe të qytetarëve. Por, vlen të theksohet të dhëna se përqindja e qytetarëve të interesuar, veçanërisht grave është vazhdimisht në rritje, që në të ardhmen do të donin të informoheshin apo të ftoheshin drejtpërdrejt nga komuna për t'u përfshirë në ndonjë aktivitet të organizuar të qytetarëve[29].

Sipas qytetarëve, ekzistojnë disa arsye të ndryshme për interesin e tyre të ulët në pjesëmarrjen e qytetarëve, si dhe për angazhimin e ulët faktik në proceset e vendimmarrjes dhe zgjidhjen e problemeve nëpër komunitetet lokale. Si vërejtje e përgjithshme, organizimi i komunave konsiderohet se mundëson përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, në përgjithësi ose në masë të vogël. Ky tregues tregon përmirësim të vogël në vitin 2022, kur është vërejtur rënie të vogël të përqindjes së qytetarëve që kishin konsideruar se mënyra e organizimit të komunës nuk mundëson fare ose në një masë shumë të vogël lejon përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal (ulje nga 59 % në vitin 2021 në 50% në vitin 2022)[30]. Sipas atyre qytetarëve që tashmë kanë qenë pjesë e ndonjë aktiviteti të qytetarëve, ulja e interesit të qytetarëve dhe rënia e vazhdueshme e tij gjatë kohës është veçanërisht si pasojë e rezultateve të dobëta të aktiviteteve të qytetarëve në të cilat ata ishin përfshirë, përkatësisht besimi se asgjë nuk ndryshohet, pasiviteti i institucioneve dhe kalimi i përgjegjësisë tek organet dhe institucionet e tjera, premtimet boshe dhe të parealizuara të pushtetit dhe mosndërmarrja e aktiviteteve në përgjigje të nevojave të tyre. Mungesa e kohës, por mosinformimi dhe mosnjohja me proceset, nisma e ulët ose kurrëfarë nisma nga vetë institucionet lidhur me kontributin e qytetarëve, gjithashtu konsiderohet si pjesë e "fajtorëve" kryesor për interesin e ulët të qytetarëve[31].

Nga pikëpamja demografike, megjithatë, analizat konfirmojnë "dominimin" shumëvjeçar të gjinisë mashkullore në proceset e zgjidhjes së problemeve dhe vendimmarrjes në nivel vendor, si dhe të personave me arsim më të lartë të arsimit forma dhe statusit social. Në kategoritë e veçanta - gratë dhe gratë nga komunitetet rurale, vërehet interes më i ulët për angazhim më aktiv të qytetarëve dhe përfshirje më të ulët në ndonjë ngjarje apo aktivitet që mund të ketë ndikim efektiv mbi jetën në komunitetin ku ata banojnë. Sipas deklaratave të grave të intervistuara, kjo është "bota e burrave" ku zëri i grave nuk merret seriozisht dhe nismat e grave janë më pak efektive në krahasim me iniciativat e burrave ose të përziera.

Për gratë nga zonat rurale, koha e kufizuar dhe ndihma e pamjaftueshme për të kryer detyrat e përditshme, që nga ana tjetër tregon punën e panjohur dhe të pavlerësuar, në mënyrë shtesë

[29] Pjesëmarrja e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut me pasqyrë shtesë mbi pandeminë Kovid-19 – Fondacioni Shoqëria e hapur, Reaktor, Qendra e Komunikimeve të Qytetarëve, Evrotink, 2021

[30] Raport nga hulumtimi i mendimit public lidhur me kënaqësinë e qytetarëve nga shërbimet në nivel lokal – UNDP, Indago, shtator 2022

[31] Pjesëmarrja e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020-2022 – Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedonia / Ndikimi I faktorëve demografik mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike dhe edukimin e votuesve në Maqedoninë e Veriut – Mbështetja e reformave zgjedhore, 2021

kufizon pjesëmarrjen e tyre civile. Përveç kësaj, paragjykimet dhe stereotipet gjinore, si dhe ndërgjegjësimi i zhvilluar dobët, përmenden si faktor demotivues.
Nëse shikojmë krahasimin ndërmjet popullsisë rurale dhe asaj urbane, popullsia urbane tregon aktivitetin më të madh, ndoshta për shkak të qasjes më të lehtë te resurset, organizatat joqeveritare dhe përgjithësisht më shumë mundësi për pjesëmarrje. Megjithatë, vërehet fakti se njerëzit që jetojnë në komunitete rurale dhe të largëta, si dhe personat me aftësi të kufizuara tregojnë interesin më të madh për të marrë pjesë në jetën civile, edhe pse ata janë më pak aktivë për shkak të mungesës së hyrjes.
Në komunitetet urbane, popullata preferon të informohet duke lexuar broshura dhe fletëpalosje, duke diskutuar çështje sociale që i shqetësojnë së bashku me kolegët dhe/ose miqtë e tyre dhe duke iu përgjigjur pyetësorëve. Ata më së paku do të merrnin pjesë në mitingje të partive politike, debatet publike apo takimet përmes internetit.
Popullsia në komunitetet rurale, nga ana tjetër tregon motivimin e ulët për pjesëmarrje të qytetarëve, përkatësisht 61% e popullsisë nuk beson në arritjen e ndryshimeve pozitive përmes angazhimit individual apo angazhimit të organizatave joqeveritare, ndërsa 20% kanë asnjë interes për politikë. Shtatë nga dhjetë persona që jetojnë në vendbanimet rurale nuk kanë qenë kurrë të përfshirë në ndonjë ngjarje, aktivitet apo proces që mund të ndikojë mbi komunitetin ose mjedisin e tyre lokal, as nuk janë të interesuar për pjesëmarrje më aktive të qytetarëve[32].

# ORGANIZATAT E QYTETARËVE

Për sa i përket sektorit civil, gjegjësisht organizatave të qytetarëve dhe qëndrueshmërisë së tyre gjatë dhe pas periudhës së pandemisë, ishin vërejtur ndryshime nga disa aspekte të ndryshme. Fillimisht, kuadri ligjor për veprimin e sektorit të qytetarëve u përmirësua, duke miratuar strategjitë e reja dhe ndryshimet e tjera ligjore, ndërsa megjithatë ulja e fondeve shtetërore dhe kufizimet aktuale për shkak të pandemisë kanë ndikuar në mënyrë negative mbi qëndrueshmërinë e tyre financiare, që edhe paraprakisht ishte e brishtë, veçanërisht te OQ-të më të vogëla dhe organizatat jashtë Shkupit. Disa nga aspektet ligjore negative përfshijnë: dispozitat e reja të Ligjit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Ligjit të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit nga viti 2021, të cilat kanë komplikuar punën e OQ-ve dhe mund të imponojnë kosto që janë joproporcionale me madhësinë dhe kapacitetet e

[32] Ndikimi i faktorëve demografik mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike dhe edukimin e votuesve në Maqedoninë e Veriut – Përkrahja e reformave zgjedhore, 2021 / Pjesëmarrja e qytetarëve dhe Perspektivat e BE-së: Analiza e mendimit publik – Reaktor – Hulumtim në veprim, 2021

disa OQ-ve; dispozita të tjera të Ligjit të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit që imponuan barrë administrative shtesë për OQ-të, siç është kushti për sigurimin e informacioneve shtesë lidhur me strukturën e tyre të pronësisë etj.. Sfidë tjetër e rëndësishme ishte zvogëlimi i mundësive të organizatave për përfaqësim dhe diskutim të hapur me institucionet shtetërore, ndërsa u ul edhe funksionimi i tyre sa i përket krijimit të ideve të reja për aktivitete dhe politika lidhur me to. Kriza kontribuoi në zbulimin e mangësive në kapacitetet sa i përket pajisjeve të nevojshme për punë funksionale të organizatave, të cilat i kufizuan ato në mundësitë e tyre për rrjetëzim dhe koordinim për përfaqësim gjatë periudhës së krizës[33].

Nga ana tjetër, as autoritetet shtetërore nuk gjetën mënyrën për t'i përfshirë organizatat në fjalë në proceset e riparimit të dëmeve të shkaktuara nga kriza, që mund të kenë efekte afatgjata mbi besimin e sektorit civil lidhur me pjesëmarrjen e tyre afatgjatë.

Mungesa e vazhdueshme e informacioneve të disponueshme publike lidhur me mënyrën e financimit të shoqatave të qytetarëve vazhdon të tregojë jotransparencën e procedurave gjatë ndarjes së fondeve, mungesën e pasqyrës së shpenzimeve të komunave dhe veçanërisht mungesën e informacioneve kthyese dhe vlerësimin e efektit nga mjetet e shpenzuara në kuadër të komutetit. Çdo vit, komunat planifikojnë fonde që i destinojnë për aktivitetet e OQ-ve, në zërin e veçantë 463 - Transferimi tek OJQ-të, por zëri i buxhetit është i ndarë në disa kategori dhe shpeshherë nga ai financohen subjekte të tjera që nuk janë të regjistruara si shoqata apo fondacione. Në periudhën e pandemisë, por edhe në çdo situatë ku komunat nuk kanë planifikuar mjete në mënyrë e duhur, menjëherë synojnë buxhetin e dedikuar për OQ-të. Komunat e mbajnë këtë zë buxhetor si sigurim që i mbulon shpenzimet e tjera dhe gjatë rishikimit të buxhetit zakonisht zvogëlohet ky zë.

Ky është një prej treguesive se sa realisht janë të interesuara komunat për zhvillimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin me sektorin civil rreth çështjeve të rëndësishme, që i referohen përmirësimit të kushteve të jetesës nëpër komunat e tyre dhe nivelit të ulët të perceptimit të shoqatave si aktorë të rëndësishëm dhe partnerë të afatgjatë në procesin e zhvillimit të komunitetit[34].

Ky konkluzion është në përputhje edhe me konstatimet e Analizës së Fondacionit për Zhvillimin e Komunitetit Lokal – Shtip[35], se OQ-të janë të përfshira në punën e komunave me kapacitet të kufizuar, përkatësisht autoritetet lokale përfitojnë nga ekspertiza dhe kapacitetet e tyre, veçanërisht gjatë hartimiti të dokumenteve strategjike komunale. Zakonisht, mbështetja nga vetëqeverisja lokale kufizohet vetëm në nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit, sigurimin e një lloji mbështetjeje dhe kufizohet edhe në çështje jo aq të rëndësishme, të cilat nuk kanë ndikim të madh mbi jetësën e qytetarëve.

Ndryshimet pozitive gjatë vitit 2021 përfshinin miratimin e Strategjisë së re për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Shoqërisë së Qytetarëve për periudhën 2022-2024, Strategjisë Nacionale për Nxitje dhe Zhvillim të Vullnetarizmit për periudhën 2021-2025, përfshirjen e suksesshme të OQ-ve në

[33] Indeksi I qëndrueshmërisë së shoqërisë së qytetarëve për Maqedoninë e Veriut në vitin 2021, USAID, FHI 260 / Pjesëmarrja e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut me pasqyrë shtesë mbi pandeminë Kovid-19 – Fondacioni Shoqëria e Hapur, Reaktor, Qendra e Komunikimeve të Qytetarëve, Evrotink, 2021

[34] Sa komunat mbështetin organizimat e qytetarëve – Rrjeti "ZAEDNICA", Shtip, 2022

[35] Analiza e praktikave ekzistuese lidhur me shfrytëzimin e mekanizmave për konsultim me qytetarët në krijimin e politikave lokale dhe efikasitetin e tyre – Kristina Haxhi-Vasileva, Fondacioni për Zhvillimin e Komunitetit Lokal, Shtip, 2017

krijimin e disa propozimligjeve, mungesën e rasteve të raportuara të ngacmimeve të OJQ-ve nga institucionet shtetërore, mungesën e kufizimeve ligjore lidhur me mundësitë e qasjes në burime të ndryshme të financimit, duke përfshirë aktivitetet ekonomike, fushatat e donacioneve, donatorët e huaj apo tenderat e prokurimeve publike etj.. Gjithashtu, në vitin 2021, mbi gjashtëdhjetë organizata të shoqërisë së qytetarëve u bashkuan për të nënshkruar Kodin e parë për organizatat e shoqërisë së qytetarëve në Maqedoninë e Veriut[36]. Kjo nismë e udhëhequr nga OQ-të i njohu rekomandimet për veprim dhe synon ruajtjen e cilësisë së aktiviteteve në kuadër të sektorit dhe arritjet. Ky dokument u miratua vullnetarisht, me ç'rast OQ-të treguan gatishmëri për ruajtjen e standardeve të larta të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe në të njëjtën kohë synon ta forcojë besimin e publikut në progresin e sektorit të qytetarëve.

Kriza e Kovid-it, përveç ndikimit të drejtpërdrejtë mbi organizatat e qytetarëve, ka ndikuar negativisht edhe mbi ndërgjegjësimin e vetë qytetarëve, gjegjësisht ekzistimin e një forme të organizuar të pjesëmarrjes dhe aktivizmit të qytetarëve në komunat ku ata banojnë. Në vitin 2022 është matur niveli më i ulët i vetëdijes së qytetarëve për organizatat joqeveritare në komunat e tyre (17%), si dhe niveli më i lartë i mungesës së motivimit për të marrë pjesë në aktivitetet e shoqatave të qytetarëve (55% e të anketuarve).

Sipas një të katërtës së qytetarëve (29%), shoqatat e qytetarëve/OJQ-të në komunë inkurajojnë qytetarët që të propozojnë zgjidhje për problemet lokale dhe që të përfshihen në punën e vetëqeverisjes lokale, por mendimet janë të ndara lidhur me atë nëse shoqatat e qytetarëve veprojnë në të vërtetë sipas prioriteteve të qytetarëve apo jo (25-26%). Në përgjithësi, një pjesë e qytetarëve pajtohen se është ide e mirë që komunat t'u dorëzojnë tërësisht disa shërbime shoqatave civile dhe besojnë se kjo do të rezultojë me shërbime më të mira, ndërsa disa besojnë se ato janë kompanitë, përkatësisht disa shërbime do të përmirësoheshin nëse komuna ua dorëzonte tërësisht kompanive.

Nga hulumtimet dhe analizat e opinionit, interesit dhe angazhimit të qytetarëve në disa vitet e fundit, konfirmohet trendi negativ i rënies së interesit të qytetarëve, besimit të qytetarëve në institucionet në nivel lokal, si dhe efektivitetit të ndikimit të qytetarëve mbi vendimet që institucionet i miratojnë. Megjithatë, të dhëna për rritjen e interesit dhe dëshirës për përfshirje në proceset e tilla, përkatësisht optimizmi i qytetarëve, jep shpresë se institucionet shtetërore do të ndërgjegjësohen dhe do ta shfrytëzojnë këtë potencial për të gjetur mekanizma për përfshirjen më të madhe të qytetarëve në këto procese, me ç'rast do të rritet edhe besimi i qytetarëve në këto institucione. Mosshfrytëzimi dhe mospërfshirja e qytetarëve mund të shkaktojë zhgënjim shtesë te qytetarët, por edhe do të shkaktojë dalje shtesë të potencialit të qytetarëve nga vendi.

[36] Kodi i Organizatave të Qytetarëve – MCMS, 2021

# METODOLOGJIA

Analiza bazohet në metodologji të kombinuar që përfshin hulumtim sekondar, grupet e fokusit, intervistat me kryetarët e komunave, këshilltarët komunal, përfaqësuesit e rajoneve të planifikimit, si dhe anketën. Secili prej këtyre komponentëve ofron këndvështrim dhe thellësi të ndryshme të hulumtimit, duke mundësuar pasqyrën e plotë të mekanizmave për pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin lokal.

U krye hulumtim sekondar për shqyrtimin e kornizës ligjore dhe literaturës akademike, duke u fokusuar mbi ligjet që rregullojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në politikëbërjen në nivelin lokal.

Grupet e fokusit kanë ofruar pasqyrë të drejtpërdrejtë në qëndrimet dhe përvojat e qytetarëve, OQ-ve, gazetarëve dhe komunitetit të biznesit, të organizuara në të gjitha tetë rajonet e planifikimit, me gjithsej 105 pjesëmarrës. Karakteristike për implementimin e hulumtimit në fjalë ishte fakti se pjesëmarrësit, siç janë qytetarët, mediat dhe veçanërisht bizneset përfshihen në mënyrë shumë të vështirë.

Intervistat me kryetarët e komunave dhe këshilltarët komunal nga partitë politike[37] kanë mundësuar pasqyrë të detajuar të qëndrimeve të autoriteteve lokale ndaj pjesëmarrjes së qytetarëve, me gjithsej 16 kryetarë të komunave të intervistuar, si dhe 16 këshilltarë nga të gjitha rajonet e planifikimit dhe partitë politike. Janë kontaktuar dhe intervistuar të gjithë përfaqësuesit e qendrave të zhvillimit të rajoneve të planifikimit, përveç rajonit jugperëndimor.

Anketa, e realizuar nga data 26 shtator 2023 deri më datë 11 janar 2024, mblodhi të dhëna nga 197 qytetarë, me qëllim që të kuptohen qëndrimet, përvojat dhe perceptimet e tyre për pjesëmarrjen gjatë procesit të vendimmarrjes në lokal. Struktura demografike e pjesëmarrësve ishte e llojllojshme, duke përfaqësuar të gjitha rajonet e planifikimit dhe tregoi përfaqësimin e konsiderueshëm të grave (63%), personave me arsim të lartë (më shumë se 80% me arsim universitar ose pasuniversitar) dhe të punësuarve (79.8%). Përkatësia etnike ishte me prezencën e grupeve etnike maqedonase, shqiptare, rome, turke, serbe dhe të tjera.

Analiza ka përfshirë aspektet kryesore të mëposhtme të pjesëmarrjes së qytetarëve:

nëse dhe si komuna i përfshin qytetarët në procesin e vendimmarrjes, duke përfshirë edhe mjetet që i përdor për këtë

[37] OBRM-PDBKM, LSDM, BDI, BESA, ASH, PLD, E Majta dhe GROM


qëllim. Kjo kategori merr parasysh perspektivat e komunës dhe përfshin çështjet që fokusohen mbi mekanizmat dhe platformat e pjesëmarrjes së qytetarëve.
temat ose fushat dhe çështjet për të cilat pushteti lokal konsultohet me qytetarët. Këtu përfshihen çështjet apo agjendat specifike për të cilat komuna kërkon interes nga qytetarët.
interesimi ose mosinteresimi i qytetarëve që të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal, si dhe shkalla e pjesëmarrjes së tyre. Kjo kategori është kyçe për të kuptuar motivimin dhe barrierat për pjesëmarrjen e qytetarëve.
mënyrat e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, suksesi dhe efektiviteti i mjeteve dhe metodave të ndryshme nga këndvështrimi i qytetarëve. Këtu përfshihen përvojat dhe perceptimet e qytetarëve për mënyrat e ndryshme të pjesëmarrjes.
efekti nga pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, duke përfshirë nëse ka pasur ndonjë efekt dhe nëse po, nëse ai efekt ka qenë pozitiv apo negativ. Kjo kategori është e rëndësishme për matjen e ndikimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në politikat dhe vendimet lokale.
Secila prej këtyre kategorive mundëson shqyrtimin e detajuar të aspekteve të ndryshme të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe ndërveprimin ndërmjet vetëqeverisjes lokale dhe qytetarëve. Nëpërmjet kësaj metodologjie, analiza synon të përftojë pasqyrën e plotë sa i përket nivelit të demokracisë dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal.

# PËRFSHIRJA NË PROCESIN E VENDIMMARRJES

Në këtë pjesë, vlerësohen qëndrimet e qytetarëve nëse dhe në cilën mënyre komuna i përfshin qytetarët në procesin e vendimmarrjes dhe me cilat mjete.

Në pyetjen: "Me notën nga 1 deri në 5 (1-keqe, 5-shkëlqyeshme) si do ta vlerësoni gatishmërinë e komunës suaj për t'i përfshirë qytetarët në procesin e vendimmarrjes në nivel komunal?", qytetarët kanë dhënë notën mesatare prej 2.34 (në shkallën nga 1 deri 5, ku 1 - e keqe, ndërsa 5 – e shkëlqyeshme) për gatishmërinë e komunës ku jetojnë për ti përfshirë qytetarët në procesin e vendimmarrjes në nivel komunal.

Sipas përgjigjeve "Si komuna juaj ju kontakton/informon për të ndarë mendimin tuaj dhe për t'u përfshirë në proceset e vendimmarrjes, që prekin komunën (Ju lutemi zgjidhni të gjitha përgjigjet përkatëse)?" pothuajse 37% e të anketuarve kanë përgjigjur "komuna nuk përfshin ne", 24.4% kanë deklaratuar se kjo bëhet përmes mediave sociale, ndërsa 18.3% kanë deklaruar se kjo bëhet përmes njoftimeve në faqen e internetit të komunës.




**Si komuna juaj ju kontakton/informon për të ndarë mendimin tuaj dhe për t'u përfshirë në proceset e vendimmarrjes?**

**Metodat e përfshirjes**


- Komuna nuk më kontakton/informon
- Përmes mediave sociale
- Duke informuar përmes internetit
- Përmes mediave konvencionale
- Dorëzimi i ftesës
- Kontakti personal
- Tjetër

Në pyetjen: A konsideroni se komuna juaj ju përfshin në procesin e vendimmarrjes?, 82,21% e të anketuarve kanë deklaruar se komuna e tyre nuk i përfshin në këto procese, ndërsa 17,79% e të anketuarve konsiderojnë se komuna e tyre i përfshin në proceset e vendimmarrjes.


Kjo tregon një mangësi të konsiderueshme në angazhimin e komunave për t'i përfshirë qytetarët në procesin e vendimmarrjes, që e thekson nevojën për përmirësimin e komunikimit dhe mundësive për përfshirje, në mënyrë që të fuqizohet pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal.

**Metodat e përfshirjes**: Në pyetjen "Në cilat mënyra komuna ju përfshin në procesin e vendimmarrjes?", numri i përgjigjeve të marra në këtë pyetje udhëzuese është 54%, përkatësisht vetëm ata që kanë përgjigjur pozitivisht në pyetjen e mësipërme kanë pasur mundësi për t'u përgjigjur. Janë marrë një sërë përgjigjesh, të cilat përfshinin sondazhe, media sociale, tribuna publike, ditë të hapura të kryetarëve të komunave etj.. Megjithatë, duket se nuk ekziston ndonjë metodë dominuese që përdoret në të gjitha komuna. Radhitja e përgjigjeve të marra sipas shpeshtësisë është si në vijim:

1. Tribuna publike: 16,81 %
2. Media sociale (Facebook, Instagram, Twitter): 14.16%
3. Forum në komunitin: 13.27%
4. Sondazhe: 10.62%
5. Mbledhje e komunitetit lokal/urban: 9,73%
6. Ditë të hapura të kryetarit: 9.73%
7. Tubim i qytetarëve: 8,85 %
8. Forume/pyetje dhe përgjigje në faqen e internetit të komunës: 7,08%
9. Bordet këshillëdhënëse: 4.42%
10. Referendum: 4,42%
11. Asnjë nga ato të cekur më lart: 0.88%





Në pyetjen “Kur keni qenë të thirrur për herë të fundit nga komuna për ta dhënë mendimin tuaj lidhur me një temë/vendim?”, 66% e të anketuarve kanë përgjigjur se nuk ishin thirrur fare.




**Perceptimi i përfshirjes**: Identifikimi nëse qytetarët konsiderojnë se opinionet dhe nevojat e tyre merren parasysh nga komuna.

Në pyetjen "Kush mendoni se është më i interesuar dhe më i disponueshëm për ta dëgjuar opinionin e qytetarëve, kryetari apo këshilltarët?", 46% e të anketuarve kanë përgjigjur kryetari/kryetarja e komunës, ndërsa 19% kanë përgjigjur këshilltarët.




Shumica e pjesëmarrësve, 74%, deklaruan se nuk ishin të përfshirë në procesin e vendimmarrjes gjatë periudhës së pandemisë Kovid.

Kjo analizë fokusohet edhe mbi dinamikën e bashkëpunimit ndërmjet palëve të ndryshme të interesit – organizatat e qytetarëve (OQ), qytetarët, sektori privat, komuniteti akademik dhe gazetarët me komunat lokale. Bashkëpunimi konsiderohet në kontekstin e perceptimeve dhe përvojave të këtyre aktorëve në ndërveprimin me autoritetet komunale.

Të dhënat nga grupet e fokusit dhe intervistat me kryetarët e komunave dhe këshilltarët zbulojnë ndryshueshmëri në cilësinë e bashkëpunimit, që varet nga sërë faktorësh, duke përfshirë dy faktorët kryesorë - vendndodhja gjeografike dhe vullneti politik i autoriteteve komunale. Sipas të dhënave, ekzistojnë nivele të ndryshme të bashkëpunimit, nga partneritete të ngushta deri në mungesë të plotë të bashkëpunimit.

Nga njëra anë, një pjesë e të intervistuarve nga grupet e fokusit kanë deklaruar se kanë bashkëpunim të mirë dhe të shkëlqyer me komunat, veçanërisht në komunat ku janë krijuar kanale për dialog dhe pjesëmarrje të qytetarëve dhe OQ-ve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Në të kundërtën, të tjerët tregojnë për pengesa të konsiderueshme dhe mungesë të bashkëpunimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për tema apo nevoja thelbësore që kërkojnë përfshirje dhe hapje më të madhe nga ana e komunave.

Të dhënat tregojnë se autoritetet lokale bëjnë përpjekje për t'i informuar qytetarët lidhur me aktivitetet e tyre, duke përdorur metoda të ndryshme të komunikimit. Megjithatë, kur bëhet fjalë për përfshirjen e qytetarëve si pjesëmarrës aktivë në procesin e vendimmarrjes, perceptohet se ekzistojnë sfida të konsiderueshme. Pavarësisht disponueshmërisë së mekanizmave të parashikuar me legjislacionin, ato përdoren rrallë në kapacitetin e tyre të plotë, pjesërisht për shkak të kompleksitetit dhe kërkesave procedurale.

Përgjigjet e marra nga intervistat me kryetarët e komunave japin një pasqyrë të metodave dhe mjeteve për konsultim me qytetarët, që kryetarët i përdorin për komunikim efektiv dhe vendimmarrje.

***"Njoftimi i përditësuar i qytetarëve... informimi derë me derë i qytetarëve, OJQ-të, ngjarjet dhe tribunat" – kryetar i komunës urbane nga rajoni juglindor***

Metodat kryesore përfshijnë kontaktin personal, ditët e hapura, nisma e qytetarëve, tubimet e qytetarëve, tribunat publike dhe propozimet. Përveç metodave tradicionale, përmenden edhe forumet buxhetore, të cilat mbahen kryesisht në qendrat urbane dhe përfshijnë palët e ndryshme të interesit, siç janë sektori i biznesit, organizatat joqeveritare, komunitetet urbane dhe grupet e këshilltarëve. Kryetarët e komunave, gjithashtu theksojnë se kontakti personal është dëshmuar që të jetë metoda më efektive. Në mënyrë shtesë, edhe pse më shumë se 50 komuna i kanë përfshirë forumet në statutet e tyre, përmendet se forumet nuk janë të përfshira në statutin e komunës, me përjashtime të rralla, që do të thotë se nuk ekziston memorie institucionale për proceset dhe protokollet e komunikimit dhe konsultimit me qytetarët. Është interesant fakti se, sipas përvojës së kryetarëve të komunave, përveç komunikimit të drejtpërdrejtë, Facebook-u është mjeti më i përdorur për komunikim nga ana e qytetarëve. Pas pandemisë Kovid-19, vërehen ndryshime në interesin e qytetarëve dhe metodat e konsultimit. Disa nga kryetarët e komunave ndajnë informacione se me rëndësi është që të rritet hapja e komunës në mënyrë që të rritet interesi i qytetarëve për pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal. Financimi i këtyre proceseve dhe aktiviteteve, gjithashtu është jashtëzakonisht i rrallë. Kryetarët e komunave janë të vetëdijshëm lidhur me rëndësinë e bashkëpunimit me sektorin e qytetarëve, mediat dhe komunitetin e biznesit për menaxhim dhe zhvillim efikas të komunës.

Perceptimet e autoriteteve lokale, sa i përket përfshirjes në proceset e vendimmarrjes, tregojnë se ata preferojnë:

- Metodat dhe mjetet për konsultim me qytetarët, kryesisht përmes tubimeve të qytetarëve dhe

takimeve të drejtpërdrejta. Shumica e komunave përdorin tubimet e qytetarëve dhe takimet e drejtpërdrejta si metodë bazë për komunikim dhe konsultim me qytetarët. Komunikimi përmes internetit, përdorimi i mediave sociale dhe mjeteve përmes internetit përdoret si përmes profileve vetanake ashtu edhe përmes profileve të komunave.

- Komunikimi i drejtpërdrejtë përmes tubimeve dhe takimeve personale konsiderohet si metoda më efektive për konsultim me qytetarët në shumë komuna. Disa komuna theksojnë se edhe përkundër përpjekjeve, ekziston reagim të dobët të qytetarëve ndaj thirrjeve për pjesëmarrje në konsultimet.

Sipas tyre, sfidat në përfshirjen e qytetarëve janë:

- Polarizimi politik dhe interesat partiake vështirësojnë proceset e përfshirjes së qytetarëve dhe ulin efektivitetin e tyre.
- Mungesa e angazhimit të qytetarëve në mënyrë aktive në disa raste, që kryetarët e komunave ia atribuojnë faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë mungesën e interesit.
- Emigrimi i të rinjve dhe ndryshimet demografike paraqesin sfidë e madhe për komunitetet lokale, veçanërisht në komunat e vogla dhe ato rurale.
- Burimet e kufizuara dhe nevoja për mbështetje financiare janë theksuar si sfida kritike për zbatimin e projekteve dhe nismave që do të plotësojnë nevojat e qytetarëve.

Qytetarët, nga ana e tyre, shfaqin të njëjtën preferencë lidhur me kontaktin e drejtpërdrejtë me vendimmarrësit, që edhe autoritetet lokale e pranojnë si metodën më efikase. Mbledhjet tradicionale në nivel të komunitetit lokal, takimet ballë për ballë dhe tribunat publike mbeten metodat më të zakonshme të konsultimit. Përveç këtyre, mjetet moderne si mediat sociale dhe faqet e internetit, të iniciuara kryesisht nga OQ-të dhe donatorët, përdoren për përmirësimin e komunikimit me qytetarët.

Përfshirja e organizatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes ndryshohet në varësi të rajonit. Në disa rajone, bashkëpunimi ndërmjet OQ-ve dhe autoriteteve lokale është i kënaqshëm, që tregon përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal. Por, në rajone të tjera, përfshirja mund t'u nënshtrohet ndikimeve politike dhe mungesës së kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale për të kuptuar nevojat e OQ-ve. Edhe në kuadër të një rajoni mund të ketë dallime të konsiderueshme nga komuna në komunë, kështu që në disa komuna bashkëpunimi me OQ-të është i shkëlqyer, ndërsa në të tjera pothuajse nuk ekziston.

***"Përfshirja e organizatave të qytetarëve, mediave dhe sektorit të biznesit në procesin e vendimmarrjes ndryshohet me ndryshimin e pushtetit – Rajoni i Pollogut***

***"Organizatat e qytetarëve kanë bashkëpunim të kënaqshëm me komunat, veçanërisht në hartimin e projekteve dhe nismave" - Rajoni Verilindor***

***"Përfshirja në vendimet shpeshherë varet nga qëndrimi dhe qasja e kryetarit të komunës" – Rajoni i Pellagonit***

Kryetarët dhe këshilltarët konsultohen me qytetarët dhe palët e tjera të interesit, duke theksuar se takimet formale dhe joformale paraqesin praktikë e zakonshme, veçanërisht në komunitetet rurale. Megjithatë, cilësia e këtyre ndërveprimeve shpesh lidhet me karakteristikat individuale të

kryetarëve të komunave dhe aftësinë dhe vullnetin e tyre për vendosjen e dialogut produktiv.

***"Ne jemi një komunë shumë e vogël me banorë dhe territor. Tubimet e qytetarëve janë mjaft të shpeshta" – Kryetar komune nga Rajoni Jugperëndimor***

***"Pikëpamje personale dhe vizitë në komunitetet lokale" – kryetar komune nga Rajoni i Vardarit"***

Disa komuna praktikojnë ditë të hapura, takime të rregullta në komunitetet lokale dhe përdorim të platformave digjitale për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e komunikimit me qytetarët. Njëkohësisht, shfaqen edhe iniciativa për mbështetjen e OQ-ve, duke ofruar hapësira për ngjarje apo edhe mbështetje financiare për projekte të caktuara.

Megjithatë, është evidente mungesa e qasjes sistematike dhe institucionalizimit të plotë të proceseve për pjesëmarrjen e qytetarëve. Në shumë raste, bashkëpunimi është sipërfaqësor, që kryhet si formalitet pa përfshirjen dhe angazhimin real për zhvillimin e komunitetit. Mungesa e burimeve, kapaciteteve dhe vullnetit politik janë theksuar si pengesat kryesore për bashkëpunim më efektiv dhe kuptimplotë.

Shembuj pozitiv të bashkëpunimit ekzistojnë mes komunave që me sukses krijojnë platforma për dialog dhe planifikim të përbashkët të projekteve me palët e interesit. P.sh., në disa komuna, projektet për gjelbërimin urban dhe përmirësimin e hapësirave publike janë realizuar me sukses me përfshirjen aktive të komuniteteve lokale dhe sektorit të biznesit. Ekzistojnë edhe shembuj ku OQ-të dhe komunat kanë punuar së bashku në programet për fushën e arsimit dhe inkluzionit, që tregon se kur ka vullnet politik dhe hapje për bashkëpunim, mund të arrihen rezultate të rëndësishme që përmirësojnë drejtpërdrejt jetesën e qytetarëve.

Përkundër shembujve pozitivë, nevoja për rritje të llogaridhënies, transparencës dhe përfshirjes aktive të të gjitha palëve relevante në proceset e vendimmarrjes mbeten sfida kryesore që duhet të adresohen për të përmirësuar cilësinë e bashkëpunimit mes qytetarëve dhe komunave.

1) VendndodhjaVendndodhja gjeografike ka rol të rëndësishëm në cilësinë e bashkëpunimit mes qytetarëve dhe komunave. Në komunat urbane, për shkak të popullsisë më të madhe dhe kompleksitetit të jetesës urbane, shpesh ka më shumë institucione, organizata joqeveritare dhe subjekte private që mund të ndikojnë dhe të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Kjo krijon më shumë mundësi për bashkëpunim, por edhe nevojë për qasje më të organizuar në koordinimin e palëve të interesit. Në të kundërtën, në komunitetet rurale, ku popullsia është më e vogël dhe komuniteti më i ngushtë, bashkëpunimi mund të jetë më intim dhe i drejtpërdrejtë, me shfaqje të shpeshta të formave joformale të komunikimit.

2) Vullneti politik i autoriteteve komunaleVullneti politik i autoriteteve komunale është ndoshta faktori më kritik që ndikon mbi cilësinë e bashkëpunimit. Komunat që udhëhiqen nga autoritetet që inkurajojnë dhe vlerësojnë në mënyrë aktive format e pjesëmarrjes së qytetarëve tregojnë hapje dhe transparencë më të madhe në procesin e tyre të punës. Në këto komuna, ekzistojnë mekanizma më të qartë për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe bëhen përpjekje për vendimmarrje gjithëpërfshirëse.

Sa i përket bashkëpunimit të pjesëmarrësve joshtetërorë me komunat sipas rajoneve, situata është e ndryshme.

- Rajoni i Vardarit: Bashkëpunimi ndërmjet qytetarëve dhe pjesëmarrësve joshtetëror me komunat në Rajonin e Vardarit ndryshohet; në disa komuna, si Komuna e Velesi dhe Kavadarit, bashkëpunimi vlerësohet si shumë i mirë ose i shkëlqyeshëm, ndërsa në të tjerat, si Komuna e Shën Nikollës, Negotinës dhe Çashkës, bashkëpunimi zhvillohet në mënyrë më të vështirë.
- Rajoni Lindor: qytetarët dhe pjesëmarrësit joshtetëror kanë bashkëpunim të mirë me komunat, veçanërisht në hartimin e strategjive dhe planeve. OQ-të janë kryesisht ato që i përfshijnë komunat në aktivitete të ndryshme, ndërsa nisma për bashkëpunim me komunën zakonisht vjen prej tyre. Megjithatë, cilësia e bashkëpunimit varet nga personat specifikë në komunat dhe njohuritë dhe ekspertiza e tyre për një temë specifike.
- Rajoni Jugperëndimor: Bashkëpunimi vlerësohet si i vështirë, veçanërisht në komunat e Strugës dhe Kërçovës, ku bashkëpunimi më së shumti varet nga lidhjet personale dhe nëse ekziston, është kryesisht deklarativ.
- Rajoni i Pellagonisë: qytetarët dhe pjesëmarrësit joshtetëror deklarojnë se bashkëpunimi mund të jetë më i mirë, por ndryshon nga komuna në komunë. Në disa raste, bashkëpunimi varet nga qëndrimi i kryetarit ndaj OQ-ve.

***"Çështja është nëse dera do të mbyllet apo do të hapet pak dhe na do të dëgjojnë. Me këtë mbaron çështja". – OQ nga Rajoni i Pellagonisë.***

- Rajoni i Pollogut: Bashkëpunimi ndryshohet në mënyrë të konsiderueshme dhe varet nga shumë faktorë, duke përfshirë ndryshimet në vetëqeverisjes lokale. Ka probleme të theksuara me komunikimin dhe transparencën.
- Rajoni Verilindor: qytetarët dhe pjesëmarrësit joshtetëror janë kryesisht të kënaqur nga bashkëpunimi me komunat, por bashkëpunimi shpesh varet nga lidhjet personale.
- Rajoni i Shkupit: Bashkëpunimi ndërmjet qytetarëvem, pjesëmarrësve joshtetëror dhe komunave në rajonin e Shkupit tregon përvoja të ndryshme, me nevojën e përmirësimit të komunikimit dhe formalizimit të bashkëpunimit.
- Rajoni Juglindor: Ngjashëm si me rajonet e tjera, bashkëpunimi edhe këtu ndryshohet dhe përballet me sfida të ngjashme. Bashkëpunimi varet edhe nga tema, gjegjësisht sa janë harmonizuar interesat e komunës me ato të OQ-ve për një temë konkrete, si dhe nga kapacitetet e komunës.


# TEMAT MBI TË CILAT FOKUSOHEN KONSULTIMET ME QYTETARËT

Kjo pjesë i referohet identifikimit të temave më të zakonshme mbi të cilat fokusohen konsultimet me qytetarët.


Në pyetjen “Në cilin nga proceset e mëposhtme jeni ftuar që të merrni pjesë në 3 vitet e fundit”, janë marrë përgjigje nga 35.5% e të anketuarve, kështu që mund të konstatohet se shumica e pjesëmarrësve nuk kanë dhënë përgjigje se ishin të përfshirë në një prej proceseve të mëposhtme, ndërsa pjesëmarrjet e tjera janë ndarë midis opsioneve të ndryshme me përfaqësim të ndryshëm. Janë ofruar opsionet e mëposhtme:

- gjatë zhvillimit të planit strategjik të komunës
- konsultim investime kapitale
- përgatitje e planeve urbanistike gjatë hartimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal
- gjatë zhvillimit të strategjisë lokale për të rinjtë
- nuk kam qenë i/e përfshirë në asnjë prej proceseve të mësipërme
- përgatitje e buxhetit të komunës
- gjatë përcaktimit të planit vjetor të punës së ndërmarrjeve publike komunale

Nga përgjigjet e marra, përgjigja më e shpeshtë është "Përgatitja e buxhetit të komunës" me 17.6%, "Nuk kam qenë i/e përfshirë në asnjë prej proceseve të mësipërme" me 17.1%, "Hartimi i planit strategjik të komunës" me 16.4%, “Përgatitje e planeve urbanistike” me 14.5%, etj.



Shumica e pjesëmarrësve (përafërsisht 68.7%) kanë deklaruar se nuk ishin thirrur nga komuna për të shprehur mendimin e tyre për temë të caktuar. Megjithatë, ekzistojnë edhe pjesëmarrës që ishin thirrur, edhe pse në masë më të vogël, gjatë vitit të kaluar ose më konkretisht gjatë zgjedhjeve lokale në vitin 2021 ose gjatë strukturës së mëparshme udhëheqëse të komunës.




Analiza e pyetjeve, që u referohen temave ose fushave për të cilat vetëqeverisjes lokale pyet qytetarët, zbulon një spektër të llojllojshëm të përgjigjeve. Megjithatë, duket se numër i konsiderueshëm i të anketuarve kanë deklaruar se komuna nuk e kërkon mendimin e tyre për ndonjë temë ose ata janë përballur me situata ku nuk janë konsultuar për vendime të caktuara. Këtu janë disa konstatime kryesore:

• Numër i konsiderueshëm i përgjigjeve tregojnë se qytetarët konsiderojnë se nuk janë konsultuar nga komunat e tyre për asnjë temë specifike.

• Ekzistojnë edhe përgjigje individuale që tregojnë fusha të veçanta, por ato janë shumë të llojllojshme, por tema që dominon në nivel të të gjitha komunave është përgatitja e buxhetit.

• Këto konstatime mund të tregojnë nevojën për përmirësimin e komunikimit dhe angazhimit ndërmjet komunave dhe qytetarëve, si dhe nevojën që komunat t'i përfshijnë qytetarët në mënyrë më aktive në bisedat rreth çështjeve dhe vendimeve me rëndësi lokale. Gjithashtu, ata sugjerojnë se mund të ketë hapësirë për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies sa i përket qeverisjes lokale.

Përgjigjet në pyetjen “Për cilat tema më shpesh komuna kërkon mendimin tuaj si qytetar?”, mund të grupohen në disa kategori sipas afërsisë së ndërsjellë të temave dhe përmbajtjes së përgjigjeve si në vijim:

1. Zhvillimi komunal dhe urban

Çështjet infrastrukturore dhe urbanizmi: “Zhvillimi urban”.

Problemet komunale: “Probleme të përditshme që lidhen me mjedisin ku jetoj”.

Buxheti dhe investimet kapitale: "Buxhetimi, problemet komunale.."

"për investime kapitale"

2. Mbrojtja e mjedisit dhe ekologjia

Ekologjia dhe mbrojtja e mjedisit jetësor: "mbrojtja e mjedisit jetësor dhe ekologjia, nevoja prej punëve të reja infrastrukturore, nevoja prej projekteve dhe ideve të reja"

"lidhur me mjedisin dhe zhvillimin lokal".

3. Temat politike dhe temat zgjedhore

0 Politike për votim dhe zgjedhje të partisë: "Politike për votimin dhe zgjedhjen e partisë ose kur zgjidhet kryetari".

"Më duhen vetëm gjatë zgjedhjeve"

4. Politikat sociale dhe rinore

Politikat për të rinjtë: "Politikat për të rinjtë"

Personat me nevoja të veçanta: "Personat me aftësi të kufizuara"

Të rinjtë dhe infrastruktura sportive"

5. Mungesa e përfshirjes

Mungesa e kërkesës për opinion: "Për asnjë temë".

Skepticizëm ndaj përfshirjes: "Nuk kërkojnë mendim për asnjë temë, vendimet i marrin vetë dhe nuk dëgjojnë kërkesat e qytetarëve"

Komuna kurrë nuk ka kërkuar mendim për ndonjë temë"

Ky grupim tregon diversitetin rreth temave në të cilat komunat mund t'i përfshijnë qytetarët, si dhe zhgënjimin dhe skepticizmin te disa qytetarë lidhur me përfshirjen e tyre në vendimet lokale.

Analiza e përgjigjeve të kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve ndaj grupit specifik të pyetjeve ofron pasqyrë në temat dhe fushat ku qytetarët konsultohen më shpesh, si dhe në proceset e përfshirjes së qytetarëve në krijimin e politikave dhe strategjive lokale.

Kryetarët e komunave theksojnë se qytetarët shpesh konsultohen rreth temave lidhur me zhvillimin lokal, urbanizmin, çështjet sociale dhe mjedisin jetësor. Konkretisht, çështjet mund të përfshijnë projektet infrastrukturore, zhvillimin e hapësirave të gjelbra, shërbimet sociale dhe arsimore, si dhe nismat për përmirësimin e cilësisë së jetesës në një komunitet. Ekziston edhe një shembull negativ i konsultimeve për ridefinimin e termit të barazisë gjinore.

***"Barazia gjinore – ndryshimi i termit" – kryetarët e komunave nga Rajoni Juglindor***

Kryetarët e komunave deklarojnë se qytetarët janë të përfshirë në zhvillimin e buxhetit lokal përmes debateve dhe anketave publike, të organizuara zakonisht para miratimit të buxhetit vjetor.

***"Propozimi i programit investues për krijimin e buxhetit për higjienë, kanalizim, ujësjellës, qen endacak, ndriçim dhe kulturë" – kryetar i një komune urbane nga rajoni i Pollogut.***

Zhvillimi i planeve urbanistike, ku konsultimet zakonisht si minimum ligjor zhvillohen përmes prezantimeve publike dhe publikimit të planeve për komente dhe sugjerime nga qytetarët.

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal dhe strategjitë e tjera, ku në mënyrë deklarative, qytetarët përfshihen përmes debateve publike.

Konsultimi për investimet kapitale, në mënyrë deklarative përmes mbledhjeve publike dhe anketave për të mbledhur mendimet dhe propozimet e qytetarëve për projektet e mëdha kapitale. Kryetarët e komunave theksojnë se bashkëpunimi me sektorin e qytetarëve është kyç për realizimin me sukses të nismave dhe projekteve lokale. Ky bashkëpunim shpesh përfshin partneritete me organizata joqeveritare për tema siç janë: arsimi, shëndetësia, ekologjia dhe promovimi i politikave rinore.
Organizatat e qytetarëve shpesh veprojnë si një urë ndërmjet autoriteteve lokale dhe qytetarëve, duke siguruar një platformë për dialog efektiv dhe pjesëmarrje të përbashkët në zhvillimin e komunitetit.

***"Konsultimet fokusohen mbi fusha specifike, siç janë: ekologjia, barazia gjinore, çështjet sociale dhe nevojat e personave me nevoja të veçanta" - pjesëmarrëse në grupin e fokusit, OQ nga Rajoni Verilindor***

***"Konsultimet me qytetarët përfshijnë temat, siç janë: hartimi i strategjive për zhvillim ekonomik lokal, planet për sektorin e bujqësisë dhe puna me të rinjtë – pjesëmarrëse në grupin e fokusit, OQ nga Rajoni Lindor***

Përgjigjet e kryetarëve të komunave tregojnë se autoritetet lokale përpiqet t'i përfshijë qytetarët në mënyra të ndryshme gjatë procesit të krijimit të politikave dhe strategjive lokale. Përfshirja e qytetarëve dhe bashkëpunimi me sektorin e qytetarlve njihen si elemente të rëndësishme për rritjen e transparencës, përmirësimin e procesit të vendimmarrjes dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm lokal. Nevoja për komunikim të vazhdueshëm dhe angazhim të qytetarëve është kyçe për krijimin e komuniteteve lokale gjithëpërfshirëse dhe të begata.

***"Komuna organizon forume për komunitetin me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë... ku qytetarët mund të marrin pjesë dhe të propozojnë projekte" - kryetar i një komune nga Rajoni Planor të Vardarit.***


***Temat janë mbrojtja e mjedisit jetësor, mushkonjat dhe ajri i ndotur."***
***"Kafshët – mbrojtje pas rasteve me helmim" – kryetar i një komune nga Rajoni Juglindor***

Në bazë të intervistave me kryetarët e komunave dhe këshilltarët, në lidhje me këto çështje, është më karakteristike se qytetarët fokusohen mbi problemet e infrastrukturës, siç janë: ndriçimi rrugor, kanalizimi, ujësjellësi dhe rrugët, që veçohen si çështje më të shpeshta për të cilat qytetarët kërkojnë zgjidhje.
Problemi me emigrimin e të rinjve dhe përpjekjet për t'i mbajtur ata në komunitetet lokale është i njohur në shumicën e komunave, veçanërisht më i theksuar është në komunat më të vogla dhe rurale, ku ka një interesim dukshëm të dobët të qytetarëve.
Temat që më së shumti i interesojnë qytetarët janë buxheti, planifikimi urbanistik dhe investimet kapitale, ndërsa autoritetet lokale janë të vetëdijshme për këtë gjë, por shpeshherë i përdorin konsultimet si formalitet. Organizatat e qytetarëve theksojnë se autoritetet në mënyrë tendencioze i përfshijnë qytetarët në rastet kur ata përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

# INTERESIMI I QYTETARËVE PËR PJESËMARRJE

Në këtë pjesë, me rëndësi është të kuptohen nivelet e angazhimit të qytetarëve në vendimet lokale dhe arsyet e interesimit apo mungesës së interesit të tyre. Ky grup e pyejteve i referohet (mos)interesimit të qytetarëve për pjesëmarrje dhe sa prej tyre kanë marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes.

Në anketën e dedikuar për qytetarët, në pyetjen "A konsideroni se komuna juaj i merr parasysh në mënyrë të barabartë nevojat dhe mendimet e grupeve të ndryshme të qytetarëve në komunitet?" është bërë përpjekje për të identifikuar se si komuna e tyre merr parasysh nevojat dhe opinionet e grupeve të ndryshme në kuadër të komunitetit. Pjesëmarrësve iu kërkua të shprehnin pikëpamjet e tyre përmes përgjigjeve lidhur me kategori të veçanta. Prej gjithsej 208 përgjigjeve, analiza e të dhënave zbulon dallime të rëndësishme në perceptimet e pjesëmarrësve lidhur me atë në cilat grupe synohen përpjekjet e komunës. Përqindjet tregojnë se sa shpesh është përmendur secila prej këtyre kategorive, duke dhënë pasqyrë se si qytetarët e perceptojnë gjithëpërfshirjen dhe fokusin e vetëqeverisjes së tyre lokale. Pjesa më e vogël e përgjigjeve është se komuna kujdeset për të gjithë në mënyrë të barabartë (17.79%), shumica prej tyre konsiderojnë se ekziston një fokus specifik mbi grupe të caktuara (njerëz të afërt me udhëheqësit 30.29%), përkatësisht shumica prej tyre konsiderjnë se komuna nuk fokusohet tek askush në veçanti (34.13%).




Përqindjet për secilën kategori lidhur me numrin e përgjithshëm të përgjigjeve (197):

- Po, kujdeset për nevojat e të gjithëve në mënyrë të barabartë: 17.79%
- Fokusohet më shumë mbi të rinjtë: 2.40%
- Fokusohet më shumë mbi femrat: 1.92%
- Fokusohet më shumë mbi romët: 4.33%
- Fokusohet më shumë mbi shqiptarët: 4.33%
- Fokusohet më shumë mbi maqedonasit: 2.88%
- Fokusohet më shumë mbi popullsinë nga komunitetet rurale: 4.81%
- Fokusohet më shumë mbi personat me nevoja të veçanta: 1.92%
- Fokusohet më shumë mbi njerëzit afër udhëheqësit: 30.29%
- Fokusohet më shumë mbi të moshuarit (pensionistët): 2.88%
- Nuk fokusohet mbi askush në veçanti: 34.13%
- Nuk e di: 11.06%

Të dhënat e përpunuara tregojnë se shumica e pjesëmarrësve **(34.13%) konsiderojnë se komuna e tyre nuk fokusohet mbi askush në veçanti, pasuar me një përqindje të konsiderueshme (30.29%) që besojnë se komuna fokusohet mbi personat e afërt me udhëhqësit.** Vetëm 17,79% e pjesëmarrësve besojnë se komuna kujdeset për nevojat e të gjitha grupeve në mënyrë të barabartë.

Nga gjithsej përgjigjet e pyetjes: "A keni marrë pjesë apo në një farë mënyre keni kontribuar në proceset e vendimmarrjes në komunën tuaj?", 36.1% e qytetarëve kanë deklaruar se kanë marrë pjesë apo në një farë mënyre kanë kontribuar në proceset e vendimmarrjes në komunën e tyre, ndërsa **63.9% e qytetarëve kanë deklaruar se nuk kanë marrë pjesë.**




Me këtë kategori të pyetjeve me rëndësi është të kuptohen nivelet e angazhimit të qytetarëve, si dhe shpeshtësia e pjesëmarrjes, përkatësisht të shihet se sa shpesh qytetarët përfshihen në procesin e vendimmarrjes në nivel komunal.


Në pyetjen “Sa herë në 3 vitet e fundit keni marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në komunën?”, kanë përgjigjur vetëm 37.5%, përkatësisht vetëm ata që janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen e mëparshme”. Nga përgjigjet e marra:

• 17.79% kanë deklaruar se kanë marrë pjesë vetëm një herë në 3 vitet e fundit,
• 12.98% kanë deklaruar se morën pjesë 2-3 herë,
• 6.73% kanë deklaruar se kanë marrë pjesë më shumë se 3 herë.

Këto përqindje na tregojnë se **ekziston dallim të dukshëm në pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, ku në mënyrë të konsiderueshme më shumë qytetarë deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë në proceset e tilla.** Ata që morën pjesë, zakonisht deklarojnë se ka qenë një herë në tre vitet e fundit, që tregon nevojën për përpjekje më të mëdha lidhur me angazhimin e qytetarëve dhe rritjen e shpeshtësisë së tyre për të marrë pjesë.

Arsyet për pjesëmarrje ose mosinteresim: Disa nga arsyet më të zakonshme të mosinteresimit për pjesëmarrje përfshijnë mungesën e kohës ose burimeve, si dhe besimin se mendimi i tyre nuk do të merret parasysh ose nuk do të ketë efekt në vendimet e komunës. Gjithashtu, disa **qytetarë deklarojnë se mendimet e tyre nuk kërkohen kurrë ose se pyetjet për të cilat kërkohen mendime janë dytësore ose të parëndësishme.**

Këto njohuri tregojnë sfidat e mundshme në angazhimin e qytetarëve në proceset lokale të vendimmarrjes. Arsyet e mosinteresimit sugjerojnë se ka hapësirë për përmirësim të komunikimit ndërmjet komunave dhe qytetarëve, si dhe nevojë për rritjen e ndërgjegjësimit, sa i përket kuptimit dhe efektit nga pjesëmarrja e qytetarëve. Komunat mund të kenë nevojë që të mendojnë lidhur me strategjitë e përmirësimit të transparencës, si dhe të zbulojnë mënyrat praktike për përfshirjen më lehtë të qytetarëve, veçanërisht ata që konsiderojnë se nuk kanë kohë ose burime të mjaftueshme për të marrë pjesë.



Pyetja “Nëse nuk keni marrë pjesë dhe nuk keni interes që të merrni pjesë në proceset e vendimmarrjes në komunën tuaj, cila është arsyeja për këtë?”, hetohen arsyet pse qytetarët nuk kanë marrë pjesë apo nuk dëshirojnë që të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes në komunën e tyre. Për këtë pyetje udhëzuese nga pyetja e mëparshme “A keni marrë pjesë apo keni kontribuar në një farë mënyre në proceset e vendimmarrjes në komunën tuaj?” përqindjet e mëposhtme janë marrë për secilën arsye të deklaruar nga gjithsej 130 përgjigje:

• Askush nga komuna nuk më ka kërkuar mendim dhe nuk më ka kontaktuar për këtë qëllim: 76.92%
• E di se mendimi im nuk do të merret parasysh ose nuk do të ketë asnjë efekt në vendimin e komunës: 15.38%
• Nuk kam kohë dhe/ose burime të mjaftueshme për detyrime të tilla: 3.85%
• Nuk më intereson politika: 2.31%
• Pyetjet për të cilat është kërkuar mendimi im janë dytësore/të parëndësishme: 1.54%
• Të tjera: 0%

Kjo tregon se shumica e qytetarëve të cilët nuk kanë marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në komunën e tyre si arsye kryesore e kanë përmendur mungesën e nismës së komunës për t'i përfshirë ata në proceset e tilla. Kjo vjen nga **perceptimi se mendimi i tyre nuk do të ketë ndikim në vendimet që miratohen**.

Përgjigjet e kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve lidhur me pyetjet që kanë të bëjnë me interesin e qytetarëve për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes, nxjerrin në pah një pamje komplekse që ndryshohet në varësi të kontekstit të secilës komunë.

***“Ka mungesë interesi për pjesëmarrje për shkak të politizimit të proceseve – kryetar i një komune të Shkupit.***
***“Njerëzit që kanë migruar në qytete dhe vende të tjera filluan të shfaqin interesin e tyre” - kryetar i një komune më të vogël.***

Kryetarët e komunave tregojnë interesin e ndryshueshëm të qytetarëve për pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes. Në raste të caktuara, për tema të caktuara ose kur bëhet fjalë për projekte specifike që i prekin drejtpërdrejt, mund të ketë rritje të interesit dhe pjesëmarrje aktive. Megjithatë, ekziston një tendencë e përgjithshme drejt pasivitetit, veçanërisht për pyetje më pak të dukshme ose komplekse që nuk nxisin përgjigje të menjëhershme emocionale ose praktike.

***"Qytetarët shfaqin letargji dhe nuk janë të motivuar që të marrin pjesë për shkak të qëndrimit të NJVL-së ndaj tyre, duke i perceptuar NJVL-të se kanë mbështetësit e tyre për ta treguar pjesëmarrjen nëpërmjet tyre" - pjesëmarrës në grup të fokusit, OQ nga Rajoni Jugperëndimor.***

***“Nismat e qytetarëve si “Manastiri në biçiklet” tregojnë përpjekje për të marrë pjesë në proceset lokale, ndonëse shpeshherë pa efekt të dukshëm” - pjesëmarrës në grup të fokusit, OQ nga Rajoni i Pellagonisë.***

Disa nga pengesat kryesore të identifikuara nga kryetarët e komunave lidhur me pjesëmarrjen aktive të qytetarëve përfshijnë mungesën e kohës, interesit apo të kuptuarit të proceseve të vetëqeverisjes lokale. Përveç kësaj, mosbesimi në autoritetet lokale dhe perceptimi se pjesëmarrja e qytetarëve nuk shkakton ndryshim real mund ta ulë në mënyrë shtesë interesin për pjesëmarrje.

Kryetarët e komunave theksojnë se nevojitet përmirësimi i komunikimit ndërmjet autoriteteve lokale dhe qytetarëve për të rritur interesin për pjesëmarrje. Kjo përfshin prezantimin e informacioneve në mënyrë më të qartë dhe më të qasshme dhe përdorimin e kanaleve të ndryshme të komunikimit për të përfshirë grupe të ndryshme të qytetarëve

***“Qytetarët janë proaktivë në pjesëmarrjen e tyre, edhe pse ndonjëherë kërkesat e tyre mund të drejtohen në vend të gabuar” – kryetar i një komune urbane nga Rajoni Lindor.***

Është njohur se informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit publike luajnë rolin kritik në rritjen e aktivitetit dhe interesit të qytetarëve për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.
Perceptimet e kryetarëve të komunave për interesin e qytetarëve që të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal sugjerojnë se ekzistojnë mundësi të konsiderueshme për përmirësim.

# MJETET EKZISTUESE PËR PJESËMARRJE DHE EFIKASITETI I TYRE

Ky grup i pyetjeve i referohet vlerësimit të mjeteve dhe metodave të ndryshme ekzistuese nga këndvështrimi i qytetarëve.
Analiza e pyetjeve na jep pasqyrë se cilat mjete përdorin qytetarët për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe cili është perceptimi i tyre për efektin nga pjesëmarrja e tyre.
Sa i përket mjeteve të pjesëmarrjes, përgjigjet duken të jenë mjaft të ndryshme dhe specifike, me përmendje të shumta të anketave si një nga mjetet që përdoren për pjesëmarrje. Kjo mund të tregojë se anketat janë metodë popullore për përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Megjithatë, përmenden edhe mjete të tjera, duke përfshirë forumet përmes internetit, mediat sociale, tribunat publike dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillit komunal, që tregon një diversitet sa i përket mënyrave të pjesëmarrjes.
Analiza e përgjigjeve në pyetjen: "Nëse keni marrë pjesë ose dëshironi të merrni pjesë në proceset e vendimmarrjes në komunën tuaj, cila formë e pjesëmarrjes, nga ato të cekura më poshtë, konsideroni se është më e përshtatshme për ju?" tregojnë se të anketuarit kanë shfaqur interes për metoda të ndryshme të pjesëmarrjes. Përgjigjet e renditura sipas përqindjeve janë si në vijim:

• Tribuna publike: 13.06%
• Anketat: 11.32%
• Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit të komunës: 10.30%
• Ditët e hapura të kryetarit: 9.58%
• Forumi në komunitet: 8,99%
• Referendumi: 8.42%
• Tubimi i qytetarëve: 7,98%
• Media sociale: 6,97%
• Mbledhja e komunitetit lokal dhe/ose urban: 6.68%
• Bordet këshilldhënëse: 5.52%
• Faqja e internetit të komunës: 5.22%
• Forumet në internet: 4,79%
• Të tjera: 1.16%

Kjo tregon se tribunat publike janë forma më e popullarizuar për pjesëmarrje me 13.06%, pastaj vijojnë pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit të komunës me 10.30% dhe ditët e hapura të kryetarit me 9.58%. Këto të dhëna tregojnë se pjesëmarrësit preferojnë forma të drejtpërdrejta dhe interaktive të pjesëmarrjes ku ata mund të marrin pjesë personalisht dhe të shprehin pikëpamjet e tyre.

Analiza e kësaj pyetje bazohet në preferencat e shprehura për format e ndryshme të pjesëmarrjes, dhe jo në numrin e saktë të pjesëmarrësve që kanë përgjigjur, për shkak se është ofruar mundësi për të përgjigjur me opsione të shumëfishta.

Tribunat publike janë forma më e popullarizuar për pjesëmarrje me 13.06%, pasuar anketat (11.32%) dhe pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit të komunës (10.30%). Kjo tregon se **qytetarët konsiderojnë se pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe mundësitë për dialog me autoritetet komunale përmes tubimeve fizike dhe anketave janë më të përshtatshme për pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes.**

Sa i përket perceptimit të efektivitetit, në pyetjen: "Nëpër cilat mjete/instrumente jeni përfshirë në proceset e vendimmarrjes në komunën tuaj?", patën mundësi që të përgjigjen vetëm ata që kanë përgjigjur pozitivisht në pyetjet e mëparshme, me ç'rast patën mundësi për t'i përgjigjur kësaj pyetjeje të destinuar. Ata tregojnë mënyrat e ndryshme të përfshirjes:


• Referendumi: 2.42%
• Tubimi i qytetarëve: 9.70%
• Tribuna publike: 10.91%
• Anketat: 13.33%
• Forume në internet/pyetje dhe përgjigje në faqen e internetit të komunës: 7.27%
• Forumi në komunitetin: 14.55%
• Mbledhja e komunitetit lokal/urban: 4.85%
• Bordet këshilldhënëse: 6.06%
• Ditët e hapura të kryetarit: 5.45%
• Media sociale: 6.67%
• Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit të komunës: 9.09%
• Peticione: 4.85%
• Asnjë nga ato të cekura më lart: 0.61%
• Të tjera: 4.24%

Instrumenti më i popullarizuar për përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në komunën e tyre është forumi në komunitetin me 14.55%, i ndjekur nga anketat me 13.33% dhe tribunat publike me 10.91%. Kjo tregon se qytetarët preferojnë komunikim të drejtpërdrejtë dhe platforma për angazhim ku mund të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe t'i shprehin pikëpamjet e tyre.

Qytetarët më së shumti vlerësojnë format e pjesëmarrjes që mundësojnë komunikim dhe ndërveprim të drejtpërdrejtë me vendimmarrësit, siç janë forumet në komunitetin, anketat dhe tribunat publike. Kjo tregon se **ka nevojë të madhe për mekanizma që mundësojnë komunikim të dukshëm të dyanshëm.**

Përdorimi i anketave si mjet pjesëmarrjeje tregon **faktin se qytetarët dëshirojnë të konsultohen dhe të kontribuojnë në vendimet e komunës në mënyrë që është e qasshme dhe nuk kërkon kohë apo burime të konsiderueshme.**

Edhe pse forumet në internet dhe faqja e internetit e komunës përfshijnë pjesë më të vogël të përgjigjeve të përgjithshme, përdorimi i tyre sugjeron se ka hapësirë për përmirësim të platformave të internetit për përfshirjen e qytetarëve.



Komunat duhet të investojnë në organizimin dhe promovimin e **më shumë forumeve në kuadër të komunitetit dhe tribunave publike, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes**.

Për të përmbushur nevojat e një game më të gjerë të qytetarëve, **komunat duhet të zhvillojnë dhe përmirësojnë platformat e internetit për pjesëmarrje**, duke përfshirë përmirësimin e forumeve të internetit dhe mediave sociale si mjete për angazhim.

Komunat duhet t'i përdorin anketat si instrument standard për mbledhjen e mendimeve dhe prioriteteve nga qytetarët, veçanërisht gjatë krijimit të politikave dhe hartimit të programeve që ndikojnë drejtpërdrejt mbi jetën e tyre.

Përveç rritjes së dukshmërisë, komunat duhet të sigurojnë se informacionet për ditët e hapura dhe mbledhjet janë lehtësisht të qasshme dhe t'i inkurajojnë qytetarët që të marrin pjesë në mënyrë aktive.

Komunat duhet të jenë të hapura ndaj ideve dhe sugjerimeve të qytetarëve lidhur me mënyrat e reja dhe inovative sa i përket pjesëmarrjes, që mund të përfshijnë zgjidhje teknologjike ose formate alternative të mbledhjes dhe debatimit.

Duke i analizuar përgjigjet e kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve ndaj pyetjeve specifike të kësaj kategorie, mund t'i identifikojmë temat kryesore që u referohen metodave dhe mjeteve të konsultimit me qytetarët, si dhe mënyrave për përmirësimin e këtij procesi në komuna të ndryshme.

Në lidhje me metodat dhe mjetet e konsultimit, kryetarët e komunave përdorin kombinimin e takimeve të drejtpërdrejta, tubimeve publike, komuniteteve lokale, mediave sociale dhe platformave digjitale për angazhimin e qytetarëve. Komunikimi i drejtpërdrejtë përmes tubimeve të qytetarëve dhe komuniteteve lokale shpesh përmendet si mënyra efektive për t'i marrë reaksionet e menjëhershme nga qytetarët dhe për ta siguruar pjesëmarrjen e tyre në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Rrjetet sociale dhe mjete të tjera të internetit përdoren gjithashtu për të arritur audiencë më të gjerë dhe për të inkurajuar dialogun mes qytetarëve dhe komunës.

***"Mediat sociale dhe takimet ballë për ballë janë metodat më efektive për përfshirjen e qytetarëve" – Kryetar i një komune urbane nga Rajoni Jugperëndimor***

***"Tubimet e qytetarëve, sipas meje, paraqesin metoda më efektive për konsultim" – kryetar i një komune rurale.***

***"Tubimi i qytetarëve – shpallja në një shitore - mediat sociale janë mënyrat e informimit" – këshilltar nga një komune rurale.***

***"Platformat digjitale dhe mediat sociale përdoren për komunikim efikas dhe angazhim të qytetarëve" – kryetar i një komune të Shkupit.***

***"Forumet, anketat, forumet buxhetore – 4 forume – me sektorin e biznesit, me organizatat joqeveritare, me komunitetet urbane dhe me grupet e këshilltarëve që kanë kërkesat e tyre" – kryetar i një komune urbane nga Rajoni i Pellagonisë.***

Sa i përket mënyrave të tjera të komunikimit/konsultimit, përveç metodave tradicionale, disa komuna kanë vendose qasje inovative, siç janë platformat digjitale për raportimin e problemeve

apo sugjerimeve, anketat dhe aplikacionet që mundësojnë komunikim më të thjeshtuar me qytetarët. Këto mjete digjitale u provuan efektive në rritjen e transparencës dhe lehtësimin e procesit të qasjes së qytetarëve.

- Ekzistojnë disa shembuj pozitivë lidhur me mjetet që komunat i përdorin, siç janë:
"Komunari im" është mjet në internet, lidhur me shërbimet e komunës dhe funksionon që nga dhjetori i vitit 2017 dhe mundëson zbulimin dhe zgjidhjen e problemeve të qytetarëve në territorin e komunës së Kavadarit. Ai përfshin një qendre thirrjeje dhe lidhje të ngushtë me Ndërmarrjen Publike "Komunalec" për veprim të koordinuar.
- "Sistemi 48" në Komunën e Strumicës është mjet që u mundëson qytetarëve të raportojnë problemet lokale përmes telefonit apo aplikacioneve të internetit, me qëllim të zgjidhjes së shpejtë të tyre. "Sistemi 48" ekziston më shumë se 10 vjet në Strumicë.
- Aplikacioni "mZaednica": Ky aplikacion është vendosur në disa komuna dhe mundëson përdorimin e digjitalizuar të shërbimeve lokale nga qytetarët. Aplikacioni në fjalë mundëson raportimin e problemeve komunale, pjesëmarrjen në zgjidhjen e problemeve lokale dhe në krijimin e politikave komunitare.
- Arkivimi i kërkesave të qytetarëve nëpër komunat. Komunat praktikojnë arkivimin e kërkesave elektronike të qytearëve, që ndihmon në adresimin në kohë dhe efikas të nevojave dhe kërkesave të tyre.

Megjithatë, ekziston hapësirë të konsiderueshme për përmirësimin e efektivitetit të mjeteve për pjesëmarrjen e organizatave të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal. Përmirësimi i komunikimit, transparencës, si dhe vendosja e zgjidhjeve inovative digjitale mund të kontribuojnë në mënyrë të ndryshme në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së bashkëpunimit ndërmjet OQ-ve dhe vetëqeverisjeve lokale. Në rajonet e Maqedonisë, organizatat e qytetarëve (OQ) përballen me sfida të ndryshme në bashkëpunimin me vetëqeverisjet lokale, ku efikasiteti i mjeteve ekzistuese të pjesëmarrjes u ndryshuan në mënyrë të konsiderueshme. Nga analiza e diskutimeve në grupet e fokusit, veçojmë disa aspekte kyçe lidhur me mjetet ekzistuese të pjesëmarrjes dhe efektivitetin e tyre.

**Rajoni i Pollogut** – edhe pse ekzistojnë memorandume bashkëpunimi midis OQ-ve dhe autoriteteve lokale, shpesh ato konsiderohen si formalitet pa zbatimin real. Efektiviteti i bashkëpunimit shpesh varet nga lidhjet personale, që tregon mungesën e qasjes sistematike ndaj gjithëpërfshirjes në proceset e vendimmarrjes.

**Rajoni i Shkupit -** komuna të ndryshme në këtë rajon tregojnë dallime të konsiderueshme në përkushtimin e tyre për vendosjen dhe përdorimin e mjeteve të reja digjitale për të përmirësuar bashkëpunimin. Përderisa disa komuna janë të hapura ndaj inovacionit dhe zbatimit të mjeteve të reja, të tjerat janë rezistente për shkak të mungesës së kapaciteteve.

**Rajoni Verilindor -** ka shembuj të bashkëpunimit të suksesshëm ku OQ-të dhe komunat iniciojnë aktivitete dhe projekte të përbashkëta. Një nga shembujt e suksesshëm është vendosja e sistemit elektronik të komunikimit midis qytetarëve dhe këshilltarëve, që tregon se efikasiteti mund të rritet përmes përdorimit të teknologjive moderne.


**Rajoni i Vardarit -** bashkëpunimi në disa komuna është shembull i praktikës së mirë, ku komunat mbështesin OQ-të, duke ofruar burime dhe hapësira për punën e tyre. Megjithatë, përvoja ndryshohet dhe tregon se bashkëpunimi efektiv kërkon një proces transparent dhe hapje për dialog me palët e ndryshme të interesit.

**Rajoni Lindor -** edhe pse OQ-të janë aktive në inicimin e bashkëpunimit, ka mungesë të kapaciteteve të vetëqeverisjeve lokale për t'i kuptuar dhe mbështetur iniciativat e tyre.

Joprofesionalizmi dhe mungesa e njohurive janë pengesa të shpeshta për bashkëpunim efektiv.
**Rajoni Jugperëndimor -** bashkëpunimi shpesh varet nga kontaktet individuale dhe iniciativat personale. OQ-të përballen me sfida në komunikimin me komunat, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje më serioze që kërkojnë mbështetjen dhe burimet e konsiderueshme.
**Rajoni i Pellagonisë -** në këtë rajon theksohet mungesa e kapaciteteve nëpër komunat për t'i kuptuar dhe mbështetur kërkesat e OQ-ve. Përkundër ekzistencës së disa nismave të suksesshme, OQ-të shpesh përdoren nga komunat në kryerjen e detyrave të tyre, pa përfshirje reale në procesin e vendimmarrjes.

# EFEKTI NGA PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË PROCESET E VENDIMMARRJES

Kjo kategori është e rëndësishme për matjen e ndikimit nga pjesëmarrja e qytetarëve në politikat dhe vendimet lokale. Pyetjet shqyrtojnë efektin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, duke përfshirë edhe atë nëse ka pasur ndonjë efekt dhe nëse po, a ai efekt ka qenë pozitiv apo negativ.
Në pyetjen: "A mendoni se ka efekt përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes?". të gjithë pjesëmarrësit mund të përgjigjen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Prej tyre, 75.48% kanë përgjigjur "po" dhe besojnë se përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes ka efekt, ndërsa 9.62% konsiderojnë se nuk ka efekt, përkatësisht 14.90% nuk janë të sigurt se përfshirja e qytetarëve ka efekt ose jo.




Në grafikun e mëposhtëm është preztuar mendimi i të anketuarve nëse ka efekt përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Shumica prej tyre konsiderojnë se ka efekt, me përqindje më të vogël të atyre që nuk janë dakord ose nuk kanë vendosur. Kjo tregon se shumicë e konsiderueshme e qytetarëve e perceptojnë përfshirjen e qytetarëve si kontribut pozitiv në procesin e vendimmarrjes.

Në pyetjen: "Çfarë efekti ka?", analiza e të dhënave për efektin e përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes tregon se 51.92% e qytetarëve besojnë se efekti është pozitiv, 0% e qytetarëve konsiderojnë se efekti është negativ, ndërsa 6.73% e qytetarëve nuk janë të sigurt për efektin.

Këto rezultate tregojnë qartë se shumica e qytetarëve besojnë se përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes perceptohet si potencial me efekt pozitiv në shoqërinë. Kjo konfirmon kuptimin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes sëq ytetarëve në proceset demokratike.

Të dhënat tregojnë se shumica prej tyre konsiderojnë se efekti është pozitiv, ndërsa një numër i vogël nuk janë të sigurt dhe nuk ka përgjigje se tregojnë efektin negativ.

Analiza e të dhënave për efektin e **pjesëmarrjes personale të qytetarëve** në proceset e vendimmarrjes në komunën e tyre përmes pyetjes "Cili ka qenë efekti i pjesëmarrjes suaj në proceset e vendimmarrjes në komunën tuaj?" tregon se:


• 25% e qytetarëve besojnë se pjesëmarrja e tyre ka pasur efekt pozitiv, përkatësisht ka pasur ndryshim për mirë.

• 17.78% e qytetarëve besojnë se pjesëmarrja e tyre ka ndikuar negativisht, përkatësisht ka pasur ndryshim për keq.

• 1.44% e qytetarëve besojnë se pjesëmarrja e tyre ka pasur efekt neutral ose nuk ka pasur ndryshim.

Grafiku i mëposhtëm tregon efektin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në komunë. Sipas përgjigjeve të marra, shumica prej tyre konsiderojnë se pjesëmarrja e tyre ka pasur efekt pozitiv (ka pasur ndryshim për mirë), ndërsa përqindje e vogël kanë vërejtur efekt


negativ (ka pasur ndryshim për keq), ndërsa pjesë e konsiderueshme e të anketuarve konsiderojnë se pjesëmarrja e tyre nuk ka sjellë ndonjë ndryshim ose efekti ka qenë neutral.




Shumica e qytetarëve e perceptojnë pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal si një gjë që ka efekt pozitiv, ndërsa numër i konsiderueshëm prej tyre konsiderojnë se pjesëmarrja e tyre nuk ka sjellë ndryshime të rëndësishme. Kjo tregon se pjesëmarrja është formale dhe nuk shkakton përfshirje të konsiderueshme të qytetarëve në nivel lokal.

Faktorët që kontribuojnë për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, të renditur sipas madhësisë së vlerës mesatare të tyre, me vlerën më të lartë në krye, janë marrë përgjigjet në pjyetjen: "Me shkallën nga 1 deri në 5, vlerësoni se në çfarë mase secili nga faktorët e mëposhtëm kontribuon në pjesëmarrjen tuaj në procesin e vendimmarrjes në nivel komunal? (1 - më së paku, 5 - më së shumti)":

1. Rëndësia e temës/çështjes që do të diskutohet: 3.94
2. Koha e lirë në dispozicion: 3.25
3. Prania e kryetarit/këshilltarëve: 3.22
4. Ftesa personale nga komuna/kryetari i komunës: 3.21
5. Afërsia me vendin ku mbahet ngjarja: 2.72
6. Kushtet në vend (të këndshme, komode, të nxehta/ftohta): 2.56
7. Shoqëria e miqve/familjarëve: 2.31
8. Sigurimi i transportit deri në vendin e ngjarjes: 2.15
9. Urdhri nga eprori/partia: 1.52




Analiza e rezultateve të kësaj pyetjeje tregon se rëndësia e temës/çështjes që do të diskutohet është faktori më i rëndësishëm që kontribuon në pjesëmarrjen e qytetarëve, me notën mesatare më të lartë prej 3.94. Nga ana tjetër, urdhri nga eprori/partia është faktori me vlerën mesatare më të ulët (1.52), që tregon se ka ndikim më të vogël në motivimin e qytetarëve për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes.

Duke i analizuar përgjigjet e përfaqësuesve të pushtetit lokal, mund të konstatojmë se ka perceptime të ndryshme për efektet e përfshirjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes dhe ndikimin e politikave në nivel vendor.

Kryetarët e komunave në përgjithësi i vlerësojnë efektet e pjesëmarrjes së qytetarëve si pozitive dhe të dobishme për komunat. Ata theksojnë se përfshirja e qytetarëve ofron njohuri dhe propozime të vlefshme që mund të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve lokale, zhvillimin e komunitetit dhe zbatimin e projekteve që i adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojat dhe prioritetet e qytetarëve.

***"Komunikimi i drejtpërdrejtë dhe forumet në komunitetin janë shembuj të suksesshëm të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes" - kryetar i një komune nga Rajoni i Vardarit"***

Disa kryetarë të komunave theksojnë se komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët përmes tubimeve publike, anketave dhe platformave digjitale paraqet mënyra më efikase për të arritur këtë përfshirje, por baza e bashkëpunimit efektiv sipas tyre është komunikimi i drejtpërdrejtë. Organizimi i forumeve në komunitetin, veçanërisht i atyre të mbështetura nga organizatat ndërkombëtare, theksohet si mekanizëm efikas për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe identifikimin e prioriteteve lokale.

Gjithashtu, bashkëpunimi me organizatat dhe grupet joqeveritare, duke përfshirë edhe të margjinalizuarit, për realizimin e projekteve që i adresojnë nevojat dhe interesat e tyre, njihet si kyç për përfshirjen e suksesshme të qytetarëve në qeverisjen lokale.

Kryetarët e komunave kanë ndanë praktika të ndryshme kur bëhet fjalë për financimin e aktiviteteve për konsultim me qytetarët. Mjetet zakonisht ndahen nga buxhetet e komunave, të alokuara posaçërisht për këtë qëllim ose përmes linjave të përgjithshme buxhetore të destinuara për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe zhvillimin e komunitetit. Ekzistojnë dallime në sasinë e fondeve të alokuara, me madhësi të ndryshme të buxheteve në varësi të madhësisë së komunës dhe burimeve në dispozicion. Pandemia KOVID-19 në disa raste ka shkaktuar ndryshime sa i përket financimit, me rregullime të buxhetit sa i përket rritjes së nevojës për mjete digjitale dhe platforma të konsultimit.

Kur bëhet fjalë për ndarjen e mjeteve për organizatat e qytetarëve, shumë komuna kanë formalizuar procedurat që sigurojnë transparencën dhe drejtësinë e procesit. Këto procedura shpesh përfshijnë thirrjet publike dhe vlerësimin e projekteve të propozuara nga organizatat e qytetarëve sipas kritereve të përcaktuara. Sa i përket financimit të shoqatave sportive në krahasim me shoqatat e tjera, raporti i mjeteve ndryshohet, ku disa komuna ndajnë në mënyrë të dukshme më shumë mjete financiare për sportin në krahasim me kulturën apo pjesëmarrjen e qytetarëve, ndërsa të tjerat përpiqen të ofrojnë mbështetje të balancuar për të gjitha llojet e aktiviteteve.

Financimi dhe ndarja e mjeteve financiare për aktivitete dhe organizata që mbështesin pjesëmarrjen dhe konsultimin e qytetarëve janë elemente kyçe për angazhimin efektiv të qytetarëve në qeverisjen dhe procesin e vendimmarrjes në nivel lokal.

Megjithatë, në praktikë, kryetarët e komunave përballen me sfida të ndryshme që mund të ndikojnë mbi efektivitetin dhe efektet e pjesëmarrjes së qytetarëve. Këtu përfshihen mungesa e burimeve, polarizimi politik dhe qytetarët aktiv dhe të informuar në mënyrë të pamjaftueshme. Kryetarët e komunave, gjithashtu theksojnë se ka nevojë për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e komunikimit me qytetarët për t'i rritur pjesëmarrjen dhe ndikimin e tyre në vendimet lokale.

Kryetarët e komunave konsiderojnë se pjesëmarrja e qytetarëve është thelbësore për zhvillimin e komuniteteve lokale dhe se mekanizmat e suksesshme për përfshirje mund të kontribuojnë në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve.

Njëkohësisht, ata pranojnë se ka sfida dhe se nevojitet përpjekje e vazhdueshme për përmirësimin e praktikave ekzistuese dhe vendosjen e mënyrave të reja të përforcimit të pjesëmarrjes dhe dialogut me qytetarët.

Në krahasim me autoritetet komunale, organizatat e shoqërisë së qytetarëve, palët e interesit joshtetërore dhe qytetarët shprehin ndjenja më të rezervuara ndaj efikasitetit dhe efektivitetit të

mekanizmave ekzistues për pjesëmarrjen e qytetarëve.
Edhe pse ekzistojnë mekanizma, siç janë forumet buxhetore dhe tribunat publike, ato shpesh reduktohen në formalitete pa fuqinë reale të qytetarëve që të ndikojnë mbi vendimet.
Takimet dhe mbledhjet e drejtpërdrejta në komunitetet lokale, gjithashtu theksohen si mënyra më efikase e komunikimit si nga OQ-të ashtu edhe nga palët joshtetërore. Kjo konfirmon se kontakti personal dhe vëmendja ndaj qytetarëve kanë një rol të rëndësishëm në krijimin e besimit dhe pjesëmarrjen aktive.

Ekzistojnë edhe shembuj konkretë pozitivë, si në vijim:

- Inkluziva nga Kumanova, anëtare e këshillit për mbrojtje sociale, punon me persona me nevoja të veçanta dhe është shembull i ndikimit të suksesshëm të politikave lokale që përmirësojnë kushtet për këtë grup;
- Në Rajonin Jugperëndimor, Koalicioni Rural nga Kërçova ka zhvilluar një program për fuqizimin ekonomik të grave në bashkëpunim me komunën e Dibrës, që kontribuon në fuqizimin ekonomik të grave;
- Në Rajonin Verilindor, projektet dhe iniciativat e OQ-ve janë përfshirë në dokumentet programore të komunave, si prioritete në programin e këshillit për mbrojtje sociale, që ndikon drejtpërdrejt mbi politikat lokale;
- Një djalë nga Shtipi sapo krijoi një aplikacion për orarin e transportit publik, i cili më vonë u pranua dhe u zbatua nga komuna, duke treguar se zgjidhjet kreative nga komuniteti mund të integrohen në mënyrë efikase në shërbimet lokale;
- Në Rajonin Lindor, OQ-të përdorin *Viber community* për komunikim më të mirë me qytetarët, që ka çuar në rritjen e transparencës së komunave gjatë shkëmbimit të informacioneve dhe aktiviteteve;
- Në Rajonin e Vardarit u përmend se në komunën e Kavadarit është themeluar Qendra rinore në bashkëpunim të OQ-ve dhe pushtetit lokal, që ofron hapësirë dhe burime për aktivitetet dhe programet që i synojnë të rinjtë. Ky partneritet jo vetëm që ofron mbështetjen e të rinjtëve, por gjithashtu rrit përfshirjen e tyre në komunitet;
- Në të njëjtin rajon, u përmend gjithashtu se në komunën e Velesit është futur një automjet për transportin e personave me aftësi të kufizuara fizike, që është rezultat i drejtpërdrejtë i bashkëpunimit dhe kontributit të OQ-ve për përmirësimin e shërbimeve publike për personat me nevoja të veçanta;
- Në Rajonin e Pellagonisë, OQ-të kanë iniciuar një nismë qytetarësh për ndërtimin e ujësjellësit në fshatin Drenovc, që me sukses ka përmirësuar kushtet e jetesës së banorëve. Kjo tregon se pjesëmarrja e OQ-ve mund të ketë efekt të rëndësishëm në zgjidhjen e problemeve konkrete lokale;
- Në Rajonin Verilindor, bashkëpunimi ndërmjet OQ-ve dhe komunave ka rezultuar me projekte të suksesshme, siç është pastrimi i borës në Likovë me ndihmën e vullnetarëve dhe makinerive komunale.

Përvojë pozitive vërehet me forumet komunale ku qytetarët marrin pjesë aktive në përcaktimin e prioriteteve të komunës. Kjo tregon nevojën e zhvillimit të platformave inkluzive për dialog ndërmjet komunave dhe qytetarëve të tyre.
Megjithatë, ekzistojnë probleme me mobilizimin e qytetarëve për të marrë pjesë në mbledhjet e

këshillit dhe në forma të tjera të pjesëmarrjes. Shpesh qytetarët janë aktivë vetëm kur janë prekur drejtpërdrejt, që tregon nevojën e përmirësimit të ndërgjegjësimit dhe motivimit të qytetarëve për pjesëmarrje më të madhe të tyre.

Duket se shumica e këshilltarëve nuk janë shumë të interesuar të konsultohen me qytetarët dhe më shumë preferojnë komunikimin dhe mbledhjen e interesave të anëtarëve partiak. Edhe vetë qytetarët nuk i konsiderojnë këshilltarët si aktorë relevantë në procesin e vendimmarrjes në kuadër të komunës, edhe pse formalisht dhe ligjërisht janë ata që i miratojnë vendimet. Perceptimi i qytetarëve dhe palëve joshtetërore është se kryetarët e komunave kanë fjalën kryesore në procesin e vendimmarrjes.

Edhe pse mediat luajnë një rol kyç në informimin e qytetarëve për aktivitetet komunale, ato përballen me sfida kur përpiqen të marrin informacione dhe deklarata nga komunat dhe ekziston rezistencë ndaj komunikimit të hapur.Tregohet se jo të gjitha mbledhjet dhe aktivitetet mbulohen gjithmonë sepse mediat nuk kanë kapacitet që të arrijnë kudo dhe mbështeten në informacionet prej komunave, por në këtë mënyrë mungon ana tjetër e informacionit. Nga ana tjetër, theksohet se në rajone të caktuara, referendumet e iniciuara nga OQ-të nuk do të kishin qenë të suksesshme pa mbështetjen e mediave. Kjo sugjeron se përmirësimi i mbulimit mediatik dhe përdorimi i platformave digjitale mund ta rrisin në mënyrë të ndryshme nivelin e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve.

Sektori i biznesit ka bashkëpunim korrekt me komunat, por kjo vlen për çështjet elementare (p.sh. grumbullimi i mbeturinave), ndërsa më vështirë është  për çështje më serioze. Disa nga proceset në komunat, në interes të sektorit, zhvillohen shumë ngadalë (p.sh. miratimi i planeve urbanistike apo furnizimi me ujë) që ndikon drejtpërdrejt mbi sektorin e biznesit. Informacionet merret nëpërmjet njohjeve personale me njerëz nga komuna, ndërsa format e organizuara të bashkëpunimit (KESL ose klubet e biznesit) janë më pak aktive dhe të suksesshme.

Edhe pse ka përpjekje për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, ende ekzistojnë sfida të rëndësishme për pjesëmarrje thelbësore. Mungesa e pjesëmarrjes cilësore, nevoja për përmirësimin e kanaleve të komunikimit, si dhe nevoja për përdorimin në mënyrë më efikase të mediave dhe platformave digjitale për të informuar dhe angazhuar qytetarët janë fushat kryesore ku mund të bëhen përmirësime të rëndësishme.

# MËSIME TË MËSUARA NGA KOVID-19

Pandemia e KOVID-19 ka pasur ndikim të rëndësishëm në çdo aspekt të jetës shoqërore, duke përfshirë proceset lokale të vendimmarrjes dhe pjesëmarrjen e qytetarëve. Që nga momenti i shpalljes në muajt e parë të vitit 2020, KOVID-19 ka shkaktuar sfida të paparashikuara për komunitetet në mbarë botën, duke i detyruar autoritetet lokale dhe nacionale që të përshtaten ndaj realiteteve të reja në mënyrë të shpejt dhe efikase.

Në vijim disa aspekte kryesore të ndikimit të KOVID-19 mbi pjesëmarrjen e qytetarëve dhe proceset e vendimmarrjes në nivel lokal:

1. Me kufizimet e distancës fizike dhe me nevojën e shtuar për të qëndruar në shtëpi, platformat digjitale u bënë mënyra kryesore e komunikimit midis autoriteteve dhe qytetarëve. Kjo situatë përshpejtoi procesin e digjitalizimit dhe ofroi mundësi të reja për pjesëmarrjen e qytetarëve përmes takimeve virtuale, anketave dhe debateve në internet.
2. Kriza shëndetësore dhe pasojat ekonomike vendosin sfida të reja përpara autoriteteve lokale, të cilat ndryshuan prioritetet në procesin e vendimmarrjes. Proceset e vendimmarrjes duhej t'u përshtateshin nevojave urgjente, si kujdesi shëndetësor dhe mbështetja socio-ekonomike e qytetarëve të prekur.
3. Autoritetet lokale duhej të tregonin fleksibilitet dhe përshtatshmëri të madhe për t'iu përgjigjur kushteve që ndryshojnë me shpejtësi. Kjo ka përfshirë edhe vendosjen e shpejtë të politikave dhe protokolleve të reja për mbrojtjen e shëndetit dhe ekonomisë.
4. Pandemia ka intensifikuar edhe kërkesën për transparencë dhe llogaridhënie nga ana e autoriteteve lidhur me vendimet e tyre dhe mënyrat e shpenzimit të mjeteve financiare publike. Qytetarët kërkojnë informacione të sakta dhe përgjigje për pyetjet e tyre lidhur me menaxhimin e krizave.
5. Pjesëmarrja qytetare ka marrë dimension të ri, duke u fokusuar mbi çështjet e shëndetit dhe sigurisë. Qytetarët dhe grupet e shoqërisë së qytetarëve u përfshinë në mënyrë aktive në shpërndarjen e ndihmës humanitare, promovimin e protokolleve shëndetësore dhe mbështetjen e grupeve të rrezikuara brenda komunitetit.
6. Pandemia e KOVID-19, gjithashtu ka zbuluar disa dobësi kritike në sistemet e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, duke vënë në dukje nevojën për mekanizma më rezistente dhe përshtatëse që mund t'i përballojnë krizat e ardhshme.

***"Gjatë Kovid-it kemi përdorur më shumë komunikime strategjike derisa komunarët nuk kanë shkuar në punë, nuk kishte komunikim dhe në parim nuk kishte dallim të madh në punën e tyre" – pjesëmarrës/e në grup fokusi, OQ nga Rajoni Juglindor***

# KONSTATIMET KRYESORE

1. Ekziston dallim të rëndësishëm në shkallën e pjesëmarrjes ndërmjet grupeve të ndryshme demografike në proceset e vendimmarrjes në nivel komunal. Disa grupe të caktuara janë përfshirë më mënyrë më aktive ose janë informuar në mënyrë më të mirë lidhur me mundësitë e pjesëmarrjes sesa të tjerat, duke u bazuar kryesisht në:

• **Përkatësinë politike -** njerëzit me përkatësi apo interes politik aktiv janë më të motivuar dhe më të informuar për pjesëmarrje në proceset lokale komunale. Ata kanë qasje më të mirë në informacionet përmes rrjeteve të tyre ose partive politike, që mund t'i inkurajojë ata që të marrin pjesë më shumë në miratimin e vendimeve në nivel komunal.

• **Humbja e vijës ndërmjet partisë dhe sferës publike** – veçanërisht në kontekst të pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes. Ekziston tendencë të dukshme ku konsultimet me qytetarët, përmes komuniteteve lokale dhe tubimeve të ndryshme publike, përdoren ndonjëherë në një kontekst që nuk mundëson ndarje të qartë midis asaj që përbën ndikim partiak dhe asaj që konsiderohet si pjesëmarrje autentike publike. Kjo mund të çojë në situata ku vendimet që duhet të jenë vetëm në interes të publikut, pa dashje ose qëllimisht, janë nën ndikim të drejtpërdrejtë të interesave partiake.

• **Përdorimi i mjeteve digjitale -** individët që përdorin në mënyrë aktive mjetet digjitale dhe mediat sociale janë më të informuar lidhur me mundësitë e pjesëmarrjes. Shkrimi dhe leximi digjital dhe qasja në internet mund të ofrojnë qasje më të lehtë në informacione komunale, anketa dhe platforma të pjesëmarrjes, që i bërë këto grupe potencialisht më të angazhuara.

• **Arsimi dhe mosha -** njerëzit me arsim të lartë shpesh kanë kuptim më të thellë të rëndësisë së pjesëmarrjes së qytetarëve dhe mund të ndihen më të përgjegjshëm për të kontribuar në komunitetin e tyre. Në mënyrë të ngjashme, të moshuarit mund të posedojnë shkallë të ndryshme të pjesëmarrjes në krahasim me gjeneratat e reja, me dallime të mundshme në interesat dhe mënyrat e pjesëmarrjes.

• **Statusi socio-ekonomik** – individët me status më të lartë socio-ekonomik posedojnë më shumë burime dhe kohë për të marrë pjesë në proceset komunale. Ata gjithashtu mund të kenë më shumë kanale ndikimi dhe të jenë më të motivuar për të përdorur burimet e tyre për të kontribuar në një komunitet.

• **Vendndodhja gjeografike -** ekzistojnë edhe dallime gjeografike lidhur me pjesëmarrjen, ku banorët e zonave urbane kanë qasje dhe mundësi të ndryshme për të marrë pjesë në krahasim me ata në zonat rurale. Këtu janë disa dallime kryesore:

**o Qasja te informacionet.** Banorët e zonave urbane zakonisht kanë qasje më të mirë te informacionet përmes mediave dhe teknologjive të ndryshme. Në zonat rurale, mungesa e internetit me brez të gjerë dhe burimet e kufizuara mediatike mund ta vështirësojnë qasjen në informacione të përditësuara lidhur me iniciativat komunale.

**o Mundësitë e pjesëmarrjes.** Zonat urbane shpesh ofrojnë platforma dhe vende të shumta për pjesëmarrje, të tilla si tubimet publike, punëtoritë dhe takimet me zyrtarët komunalë. Zonat rurale

mund të përballen me kufizime për shkak të distancës më të madhe gjeografike dhe mundësive më pak të organizuara për pjesëmarrje.

**o Pjesëmarrja digjitale.** Pandemia e KOVID-19 ka përshpejtuar kalimin ndaj formave digjitale të pjesëmarrjes. Serisa kjo paraqet mundësi për banorët në zonat urbane me qasje të lehtë në internet, në zonat rurale mbetet një sfidë për shkak të infrastrukturës së kufizuar digjitale dhe shkrim-leximit digjital.

**o Përfaqësim i organizuar.** Zonat urbane shpesh kanë numër të madh të grupeve të organizuara, duke përfshirë OJQ-të, që mund të lehtësojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin. Në zonat rurale, qytetarët mund të varen më shumë nga iniciativat individuale ose nga grupet më të vogla lokale.

**o Çështje specifike lokale.** Lloji i çështjeve që motivojnë qytetarët që të marrin pjesë mund të ndryshohen sipas vendndodhjes gjeografike. Banorët në zonat urbane mund të fokusohen në temat, siç janë planifikimi urban dhe transporti publik, ndërsa banorët në zonat rurale mund të fokusohen në çështjet, siç janë bujqësia, qasje në shërbimet bazë dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale.

2. Cilësia dhe disponueshmëria e informacionve që komunat ua ofrojnë qytetarëve mund të ndikojë dukshëm mbi aftësinë dhe vullnetin e tyre për të marrë pjesë në proceset komunale. Kanalet më efektive të komunikimit përmirësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve. Grupet e veçanta angazhohen ndryshe:

• **Të rinjtë dhe digjitalisht të shkolluarit.** Këto grupe shpesh përdorin internetin dhe mediat sociale si burimi kryesor i informacioneve. Nëse komunat përdorin në mënyrë aktive platformat digjitale për komunikim dhe angazhim, qytetarët e rinj dhe digjitalisht të shkolluarit mund të jenë më të angazhuar për shkak të qasjes më të lehtë në informacionet përkatëse.

• **Pjesëmarrja e biznesit në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal.** Bizneset, veçanërisht ato që janë punëdhënës të rëndësishëm në një komunë, kanë marrëdhënie indirekte për komunikim të drejtpërdrejtë dhe joformal me komunat dhe duhet ta rrisin interesin e tyre për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel komunal mbi bazë të rregullta. Kjo mund ta përfshijë pjesëmarrjen në konsultimet publike, grupet e punës ose këshillat që merren me zhvillimin ekonomik.

• **Anëtarët aktivë të komunitetit dhe OJQ-të.** Individët të cilët tashmë kanë marrë pjesë në aktivitetet e komunitetit ose janë anëtarë të organizatave joqeveritare mund të jenë më të angazhuar sepse kërkojnë në mënyrë aktive informacione rreth nismave lokale dhe mundësive për pjesëmarrje. Ky grup mund të jetë më i informuar dhe i motivuar për të kontribuar në vendimet në nivel komunal.

• **Qytetarët me arsim të lartë dhe profesionistët.** Individët me arsim të lartë ose ata në profesione që kërkojnë mendim dhe analizë kritike mund të jenë më të prirur për t'u përfshirë në aktivitete të komunitetit lokal, pasi priren t'i vlerësojnë informacionet dhe dëshirojnë të kontribuojnë në përmirësimin e komuniteteve të tyre.

• **Qytetarët me qasje në mediat lokale.** Individët që ndjekin rregullisht mediat lokale (tradicionale ose në internet) janë më të informuar për ngjarjet dhe nismat komunale dhe potencialisht më të angazhuar në proceset e vendimmarrjes për shkak se çështjet lokale i kuptojnë në mënyrë më të mirë.

• **Qytetarët në zonat urbane kundrejt zonave rurale.** Qytetarët në zonat urbane mund të kenë nivele të ndryshme të angazhimit në krahasim me ata në zonat rurale, pjesërisht për shkak të qasjes së ndryshme në informacionet. Banorët në zonat urbane mund të kenë qasje më të mirë në mjetet digjitale dhe mediat lokale, ndërsa qytetarët në zonat rurale mund të varen më shumë nga metodat tradicionale të komunikimit.

3. Përmirësimi i perceptimit të qytetarëve për efektivitetin e mekanizmave ekzistues të pjesëmarrjes mund të ketë ndikim të rëndësishëm në përfshirjen e tyre në të ardhmen. Nëse qytetarët besojnë se kontributet e tyre do të kenë efekt real, ata ndoshta do të jenë më të motivuar për të marrë pjesë. Perceptimi i efektivitetit nga pjesëmarrja rritet përmes:

• **Qytetarëve që më parë kanë pasur përvojë pozitive.** Individët që kanë pasur përvojë pozitive në të kaluarën duke marrë pjesë në iniciativat komunale dhe kontributi i të cilëve është i njohur ose i vlerësuar në mënyrë të dukshme mund të jenë më të motivuar për ta vazhduar pjesëmarrjen. Përvojat pozitive mund t'i inkurajojnë ata që të besojnë në efektivitetin e pjesëmarrjes së qytetarëve.

• **Aktivistëve dhe anëtarëve të OJQ-ve.** Personat që janë angazhuar në mënyrë aktive në OJQ-të ose grupet aktiviste mund të jenë më të motivuar për të marrë pjesë, sepse ata janë të përkushtuar ndaj ndryshimit dhe besojnë në fuqinë e veprimit kolektiv në nivel lokal. Ky grup zakonisht ka perceptim të lartë të efektivitetit të mundshëm nga pjesëmarrja e tyre.

• **Qytetarëve që janë përballur me probleme specifike.** Qytetarët që kanë hasur drejtpërdrejt probleme ose sfida në komunitetin e tyre mund të jenë më të motivuar për të marrë pjesë, duke pasur parasysh shpresën se do të kontribuojnë në zgjidhjen e tyre. Përvoja personale për çështje konkrete mund ta rrisë në mënyrë të ndjeshme perceptimin e tyre për efektivitetin e pjesëmarrjes.

• **Qytetarëve të arsimuar dhe të informuar.** Personat me nivel të lartë të arsimit ose ata që kërkojnë në mënyrë aktive informacione dhe janë të mirëinformuar për çështjet lokale mund të kenë vetëdije më të zhvilluar për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre. Ky grup mund të besojë se mendimet e tyre të arsimuara dhe të informuara mund të kontribuojnë në miratimin e vendimeve më të mira në nivel komunal.

• **Qytetarëve me një ndjenjë të fortë të komunitetit.** Personat që posedojnë ndjenjë të fortë të përkatësisë ndaj komunitetit të tyre dhe janë të përkushtuar në përmirësimin e tij mund të jenë më të motivuar për të marrë pjesë. Ky grup percepton pjesëmarrjen si pjesë e përgjegjësisë së tyre ndaj komunitetit dhe beson se kontributet e tyre mund të bëjnë ndryshim.

4. Ekzistojnë dallime të konsiderueshme në praktikat dhe nismat për pjesëmarrjen e qytetarëve ndërmjet komunave të ndryshme. Praktikat transparente dhe gjithëpërfshirëse jo vetëm që rrisin nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve, por edhe përforcojnë besimin mes qytetarëve dhe autoriteteve komunale, duke krijuar atmosferë më të favorshme për bashkëpunim të përbashkët dhe zhvillim të komunitetit. Komunat që zbatojnë praktika më transparente dhe gjithëpërfshirëse zakonisht mundësojnë pjesëmarrjen më të mirë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, përmes:

• **Mbledhjeve të hapura të Këshillit** – praktika ku mbledhjet e këshillit komunal janë të hapura për publikun, me mundësi të monitorimit të drejtpërdrejtë ose transmetimit përmes internetit, mundëson transparencë më të madhe dhe inkurajon pjesëmarrjen e qytetarëve.

• **Platformave për pjesëmarrje elektronike -** zhvillimi i platformave digjitale, që u mundësojnë qytetarëve të bëjnë propozime, të komentojnë propozimet e komunës dhe të votojnë për iniciativa të caktuara, rrisin gjithëpërfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive.

• **Konsultimeve dhe punëtorive publike -** organizimi i konsultimeve dhe punëtorive të rregullta publike, ku qytetarët mund të marrin pjesë në fazat e hershme të planifikimit dhe vendimmarrjes për projektet dhe politikat lokale.

• **Buxheteve qytetare** – vendosja e mekanizmave, siç janë buxhetet qytetare, ku qytetarët kanë një rol në vendosjen se si komuna duhet t'i shpenzojë financat e saj, veçanërisht për projekte apo nisma të caktuara.

• **Qasjes në informacione -** komunat që në mënyrë aktive publikojnë informacione për aktivitetet, planet, buxhetet dhe vendimet e tyre edhe atë në një mënyrë lehtësisht të arritshme dhe të kuptueshme, përmirësojnë transparencën dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve.

• **Mekanizmave të lidhjes kthyese -** zhvillimi i sistemeve përmes të cilave qytetarët lehtë mund t'i japin komente komunës për çështje të ndryshme, duke përfshirë mekanizmat për ankesa dhe sugjerime.

• **Rolit të mediave lokale dhe OJQ-ve -** bashkëpunim me mediat lokale dhe organizatat joqeveritare për të rritur ndërgjegjësimin dhe angazhimin e qytetarëve në proceset komunale.

5. Pandemia e KOVID-19 ka pasur ndikim të konsiderueshëm mbi mekanizmat dhe mundësitë e pjesëmarrjes së qytetarëve, duke preferuar më shumë format digjitale të pjesëmarrjes. Transformimi i tillë paraqet edhe sfidë edhe mundësi që komunat të përshtatin dhe përmirësojnë strategjitë e tyre sa i përket përfshirjes së qytetarëve. Disa nga format kryesore digjitale të pjesëmarrjes, që u theksuan gjatë pandemisë, i përfshijnë:

• **Mbledhjet virtuale dhe takimet publike**, përmes platformave të tilla si Zoom, Microsoft Teams ose Webex, komunat organizuan mbledhje të këshillave dhe takime publike në të cilat qytetarët mund të merrnin pjesë nga distanca. Kjo mundësoi vazhdimësinë e pjesëmarrjes edhe kur grumbullimi fizik ishte i kufizuar.

• **Platformat online për pjesëmarrje përmes internetit**, zhvillimi i platformave të specializuara përmes internetit, që u mundësojnë qytetarëve të dorëzojnë propozime, të votojnë për iniciativat lokale dhe të japin komente lidhur me planet dhe projektet e komunës. Këto platforma kanë rritur mundësitë për pjesëmarrje të gjerë.

• **Mjetet digjitale për informim të kthyeshëm,** vendosja e aplikacioneve dhe faqeve të internetit ku qytetarët mund të raportojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë problemet (si gropat në rrugë, ndriçimi, mbeturinat), që i bën shërbimet komunale më reaktive dhe të hapura ndaj nevojave të qytetarëve.

• **Mediat sociale për angazhim dhe informim**, gjatë pandemisë së Kovid-19, u intensifikua përdorimi i mediave sociale nga komunat, me qëllim që të informohen qytetarët për çështjet aktuale, për të ndarë informacione të rëndësishme dhe për të nxitur dialogun dhe pjesëmarrjen në hapësirën e internetit.

• **Anketat dhe hulumtimet digjitale**, zbatimi i anketave dhe hulumtimeve përmes internetit për marrjen e opinioneve dhe perceptimeve të qytetarëve lidhur me çështjet e ndryshme lokale, që mundëson mbledhjen e shpejtë dhe efektive të të dhënave për përmirësimin e politikave dhe shërbimeve.

Edhe pse kalimi në format digjitale të pjesëmarrjes ofron mundësi të rëndësishme për rritjen e angazhimit qytetar, ai gjithashtu paraqet sfida që lidhen me shkrim-leximin digjital, qasjen te teknologjia dhe interneti, si dhe nevojën e mbrojtjes së privatësisë dhe sigurisë së të dhënave. Komunat duhet të punojnë për të përshtatur dhe përmirësuar strategjitë e tyre në mënyrë që ato të jenë gjithëpërfshirëse dhe të qasshme për të gjithë qytetarët, me qëllim që të sigurohen se të gjitha segmentet e popullsisë të mund të marrin pjesë në mënyrë efektive në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal.

Ka hapësirë të konsiderueshme për krijimin e partneriteteve me palët e tjerë në nivel lokal, që paraqet gjë kyçe për zbatimin e suksesshëm të politikave dhe projekteve që synojnë të mirën e përgjithshme të komunitetit. Përfshirja e palëve të ndryshme të interesit mund të ofrojë perspektivë të gjerë dhe burime që mund ta përmirësojnë në mënyrë të ndjeshme cilësinë dhe efektivitetin e nismave lokale përmes:

**1. Përfshirjes së bizneseve dhe industrisë lokale**, ekziston hapësirë të konsiderueshme për bashkëpunim me bizneset lokale për përmirësimin e burimeve ekonomike dhe teknike në projekte të përbashkëta. Kjo mund ta përfshijë mbështetjen për ngjarje lokale, investime në infrastrukturë të përbashkët ose partneritete për programet e zhvillimit.

• **Partneritete ndërmjet sektorit publik dhe privat**, komunat të bashkëpunojnë me bizneset lokale në projekte që përmirësojnë infrastrukturën, shërbimet publike ose ekonominë lokale. Partneritetet e tilla jo vetëm që rrisin mundësitë për bizneset, por kontribuojnë edhe në përmirësimin e cilësisë së jetesës brenda komunitetit.

• **Ndikimi i politikave rregullatore,** bizneset mund të motivohen veçanërisht për të marrë pjesë në diskutime rreth rregulloreve dhe politikave lokale që ndikojnë drejtpërdrejt mbi operacionet e tyre. Angazhimi aktiv mund të ndihmojë në krijimin e politikave që mbështesin klimën e biznesit, duke mbrojtur njëkohësisht komunitetin dhe mjedisin jetësor.

• **Digjitalizimi dhe inovacioni**, komunat mund të promovojnë digjitalizimin dhe inovacionin për të krijuar mjedis të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e bizneseve. Kjo përfshin mbështetjen për startup-et, zhvillimin e parqeve teknologjike dhe sigurimin e burimeve për transformimin digjital.

**2. Bashkëpunimit me organizatat joqeveritare (OJQ) dhe organizatat e shoqërisë së qytetarëve**, OJQ-të dhe organizatat e qytetarëve shpesh kanë njohuri dhe përvojë specifike në fusha të caktuara si mjedisi jetësor, drejtësia sociale dhe trashëgimia kulturore. Ato mund të kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e projekteve, si dhe të ndihmojnë në mobilizimin e komunitetit.

**3. Zhvillimit të forumeve dhe grupeve të punës shumësektoriale**, krijimi i platformave ku palë të ndryshme lokale mund të takohen, diskutojnë dhe planifikojnë aktivitete të përbashkëta është çelësi për krijimin e partneriteteve të forta dhe të qëndrueshme. Kjo u mundëson të gjitha palëve të interesit të kontribuojnë dhe të ndiejnë pjesë e procesit të vendimmarrjes.

Krijimi i partneriteteve me palë të tjerë në nivel lokal jo vetëm që rrit kapacitetin për realizimin e projekteve, por gjithashtu rrit ndjenjën e përbashkësisë dhe vetësisë te qytetarët, që paraqet bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit lokal.

# MUNDËSITË PËR PËRMIRËSIM

• **Gatishmëria e ulët e komunave për përfshirjen e qytetarëve**, qytetarët kanë dhënë shkallën mesatare prej 2.34 për gatishmërinë e komunave për t'i përfshirë në proceset e vendimmarrjes, që tregon gatishmëri dhe aktivitet të pamjaftueshëm të komunave në këtë aspekt.

• **Përfshirja e kufizuar përmes komunikimit të drejtpërdrejtë**, përqindje e madhe e të

anketuarve kanë deklaruar se nuk janë të përfshirë në proceset e vendimmarrjes ose se komuna nuk i kontakton për ta treguar mendimin e tyre.

• **Nevoja për përmirësimin e metodave të përfshirjes**, edhe pse ekzistojnë metoda të ndryshme të përfshirjes, siç janë: tribunat publike, mediat sociale dhe anketat, rezultatet tregojnë se ka nevojë për përmirësimin e metodave, me qëllim që të zbatohen më lehtë.

• **Praktika ekzistuese e përfshirjes**, edhe pse komunat kanë metoda të ndryshme për përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, vërehet veçanërisht mungesë e theksuar e konsistencës dhe efektivitetit në zbatimin e tyre. Qytetarët shpesh mendojnë se nuk janë në mënyrë të mjaftueshme të informuar apo të përfshirë në vendimmarrjen kritike.

• **Interesat dhe prioritetet e qytetarëve,** ka interes të qartë të qytetarëve për pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes lidhur me zhvillimin komunal dhe urban, mbrojtjen e mjedisit jetësorm si dhe politikat sociale dhe rinore. Kjo tregon nevojën për fokus më të madh mbi këto fusha gjatë planifikimit të aktiviteteve konsultative.

• **Mosinteresimi i konsiderueshëm për pjesëmarrje,** përqindje e lartë e qytetarëve kanë shprehur mungesë interesimi ose pjesëmarrjeje në proceset e vendimmarrjes në nivel komunal. Kjo tregon nevojën për përfshirje dhe aktivizim më të mirë të qytetarëve në proceset demokratike.

• **Arsyet për mosinteresimin,** arsyet më të zakonshme të mosinteresimit përfshijnë mungesën e kohës dhe burimeve ose besimin se mendimi i tyre nuk do të merret parasysh. Gjithashtu, pjesë e konsiderueshme e qytetarëve kanë deklaruar se nuk ndihen mjaft të informuar apo të ftuar që të marrin pjesë.

• **Forumet në komunitet, anketat dhe forumet publike janë metodat më të njohura të pjesëmarrjes,** që tregojnë vlerën e lartë të komunikimit dhe ndërveprimit të drejtpërdrejtë ndërmjet qytetarëve dhe vendimmarrësve.

• **Qytetarët konsiderojnë se anketat janë instrument i rëndësishëm për shprehjen e opinioneve dhe prioriteteve të tyre,** që tregon nevojën komunat t'i përdorin anketat si mekanizëm standard për konsultimin e qytetarëve.

• **Ka potencial për përmirësimin e platformave të internetit për pjesëmarrje,** siç janë forumet e internetit dhe mediat sociale, të cilat mund të rrisin mundësitë e pjesëmarrjes për një gamë të gjerë të qytetarëve.

• **Potenciali për efekt pozitiv nga pjesëmarrja thelbësore**, shumica e të anketuarve konsiderojnë se përfshirja thelbësore e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes ka potencial që të shkaktojë efekt pozitiv. Kjo tregon se qytetarët konsiderojnë se pjesëmarrja e tyre më domethënëse mund të kontribuojë në vendime më të mira dhe ndryshime pozitive në komunitetin e tyre.

• **Pjesëmarrja e qytetarëve konsiderohet e rëndësishme për qeverisjen lokale -** Shumica e qytetarëve e shohin pjesëmarrjen e qytetarëve si kontribut pozitiv në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, duke treguar vlerë të lartë që qytetarët i përkushtojnë pjesëmarrjes së tyre.

• **Ekziston nevoja për rritjen e efikasitetit dhe dukshmërisë së përfshirjes së qytetarëve** – Edhe pse shumica e qytetarëve konsiderojnë se pjesëmarrja e tyre ka potencial për një efekt pozitiv, ende ka nevojë për përmirësimin e mekanizmave të përfshirjes për rritjen e efikasitetit dhe dukshmërisë së kontributeve të tyre.

# BIBLIOGRAFIA


1. Анализа на постоечките практики на користење на механизмите за консултација со граѓаните во креирањето на локалните политики и нивната ефикасност [Електронски извор] / [Кристина Хаџи-Василева]. - Штип: Фондација за развој на локалната заедница, 2017;
2. Закон за локална самоуправа, 2002 „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 5/2022 од 29 јануари 2002 година;
3. Закон за референдум, - (“Сл. весник на РМ“ бр.81/2005); Одлука на Уставниот суд на Република Македонија У.бр.195/2005 од 21 и 22 декември 2005 година, (Сл. весник на РМ бр.81/2005 бр.3/2006);
4. Извештај за оценка на спроведувањето на Законот за локалната самоуправа- Министерство за локална самоуправа, април 2020/Анализа на постоечките практики на користење на механизмите за консултација со граѓаните во креирањето на локалните политики и нивната ефективност - Фондација за развој на локалната заедница Штип, 2017;
5. Законот за изменување и дополнување на Законот за финансирање на единиците на локалната самоуправа („Службен весник на РСМ“ бр.173/22);
6. Закон за Буџети („Службен весник на РСМ“, бр. 203 од 19.9.2022 година);
7. Закон за извршување на буџети („Службен весник на РСМ“, бр. 282 од 27.12.2022 година);
8. Закон за слободен пристап до информации од јавен карактер („Службен весник на РСМ“, бр. 101 од 22.15.2029 година);
9. Правна анализа на предложените измени на Законот за слободен пристап до информации од јавен карактер - ОБСЕ, 2018;
10. Кодекс за транспарентност на локално ниво, УСАИД, септември, 2022 година;
11. Индекс на активна транспарентност 2023 - Фондација - Отворено општество и Центар за граѓански комуникации, јули 2023 година;
12. Проценка на доброто управување во единиците на локалната самоуправа во Република Северна Македонија преку индексот на отвореност - Фондација Метаморфозис, август 2022;
13. Програма за одржлив локален развој и децентрализација 2021-2026 година - Министерство за локална самоуправа;
14. Закон за рамномерен регионален развој („Службен весник на РСМ“, бр. 24 од 29.01.2021 година);
15. Стратегија за регионален развој на РСМ - 2021-2031 година;
16. Регионални форуми на заедницата алатка за идентификација, приоретизирање и подготовка на проекти за финансирање од МЛС и БРР-БРР, 2020;
17. Индекс на одржливост на граѓанското општество за Северна Македонија во 2021 година, УСАИД, ФХИ 360;
18. Мисија на ОДИХР за набљудување на избори Конечен извештај од Локални избори 17 и 31 октомври, 2021 година;
19. Ревидиран извештај за спроведените избори за членови на Советите на општините и Советот на град Скопје и градоначалници на општините и Градоначалник на град Скопје - Државна изборна комисија/ https://rb.gy/pkjuo;
20. Изборен Законик, март 2024, https://drive.google.com/file/d/1ZJMruqcNI-yC5VuWSzpfT9BFeKphm5An/view (пристапено 5 април 2024);
21. Граѓанското учество во Република Северна Македонија 2020-2022 - Фондација Отворено општество – Македонија;
22. Граѓаните и нивните заедници: Граѓанското учество, активизмот и волонтерството во Р. Македонија - ФООМ, Реактор- Скопје, 2016;
23. Граѓанското учество во Република Северна Македонија со дополнителен осврт на пандемијата со Ковид-19 - Фондација - Отворено Општество, Реактор, Центар за граѓански комуникации, Евротинк, 2021;
24. Извештај од истражувањето на јавното мислење за задоволството на граѓаните од локалните услуги - УНДП, Индаго, септември 2022;
25. Граѓанско учество и ЕУ перспективи: Анализа на јавното мислење – Реактор- Истражување во акција, 2021.

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323.21:352.077(497.7)"2023"(047.31)
061.2:352.077(497.7)"2023"(047.31)

HULUMTIMI i mekanizmave për pjesëmarrjen e qytetarëve / Kristina Haxhi-Vasileva... [и др.] ; përkthim Dalibor Sandev. - Shtip : Fondacioni për Zhvillimin e Komunitet Lokal, 2024 (Shtip : Motiv Plus). - 60 стр. : илустр. ; 24 см

Фусноти кон текстот. - Останати автори: Elena Timçeva, Aleksandar Kolekeski, Kristijan Panev. - Библиографија: стр. 58

ISBN 978-608-4886-08-2

1. Haxhi-Vasileva, Kristina [автор] 2. Timçeva, Elena [автор] 3. Kolekeski, Aleksandar [автор] 4. Panev, Kristijan [автор]

а) Граѓанско учество -- Механизми -- Локална самоуправа -- Македонија – 2023 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 63827205

2023

FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОПШТЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

ФОНДАЦИЈА ЗА РАЗВОЈ НА ЛОКАЛНАТА ЗАЕДНИЦА
LOCAL COMMUNITY DEVELOPMENT FOUNDATION

# HULUMTIMI I MEKANIZMAVE PËR PJESËMARRJEN E QYTETARËVE

Ky projekt financohet nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia.
"Përmbajtja është përgjegjësia e vetme e autorëve dhe Fondacionit për Zhvillim të Komunitetit Lokal - Shtip dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk mund të konsiderohet se i reflekton pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedonia".

www.frlz.org.mk
www.zaedno.frlz.org.mk
www.recikliraj.mk
frlz.shtip
frlz.org
ФРЛЗ ШТИП/LCDF Shtip
info@frlz.org.mk